

Demokracia e Kosovës në rrezik?

Paqëndrueshmëria e sistemit partiak, kohëzgjatja e qeverisë dhe kriza institucionale në Kosovë



Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj

Demokracia e Kosovës në rrezik?

**Paqëndrueshmëria e sistemit partiak,
kohëzgjatja e qeverisë dhe kriza
institucionale në Kosovë**

Prishtinë, maj 2018

Të drejtat e autorit © 2018. Instituti Demokraci për zhvillim (D4D).

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Përveç për citate të shkurtra për qëllime të kritikës dhe shqyrtimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sistem arkivimi, ose të transmetohet në çfarëdo forme ose mjete, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose tjetër, pa lejen paraprake të D4D.

Përgatitur nga:

Dr. Besnik Pula

“Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Demokraci për Zhvillim (D4D) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së.”

Përmbajtja

Përmbledhje, 7

Hyrje, 10

Historiku i zhvillimit demokratik të Kosovës që nga pavarësia, 12

Teposhtëzja rrëshqitëse? Kohëzgjatja e qeverisë dhe

paqëndrueshmëria zgjedhore, 15

Qeveria Thaçi I, 2008-11, 20

Qeveria Thaçi II, 2011-14, 22

Qeveria Mustafa, 2014-17, 25

Ndëshkimi i zyrtarëve ekzistues? Tendencat në paqëndrueshmërinë
zgjedhore, 27

Krizat institucionale dhe origjina e tyre politike, 35

Zgjedhjet e vitit 2014, 39

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese i vitit 2014 dhe zgjedhjet e vitit 2017, 43

Paqartësitë dhe kompleksiteti në procesin e formimit të qeverisë së

Kosovës, 50

Konkluzionet dhe rekomandimet, 55

Bibliografia, 61

Lista e publikimeve, 63

Përmbledhje

Ky studim trajton tri fusha shqetësuese për zhvillimin demokratik të Kosovës: stabilitetin dhe kohëzgjatjen e qeverive, paqëndrueshmërinë zgjedhore dhe kohëzgjatjen e proceseve përfshirë negocimin dhe formimin e koalicioneve qeverisëse pas zgjedhjeve. Që nga pavarësia në vitin 2008, asnjë qeveri në Kosovë nuk e ka përfunduar një mandat të plotë. Kjo ka çuar në shqetësime rreth stabilitetit politik dhe konsolidimit demokratik të Kosovës. Megjithatë, në kundërshtim me perceptimet e përgjithshme, qeveritë e Kosovës janë relativisht jetëgjata. Në të vërtetë, qeveritë e Kosovës që nga viti 2008 bëjnë pjesë në grupin e qeverive me jetëgjata në krahasim me demokracitë parlamentare evropiane. Ngjashëm, paqëndrueshmëria zgjedhore e Kosovës e matur me indeksin Pedersen, ndonëse relativisht e lartë, hyn në kategorinë e demokracive të tjera të Evropës që janë në tranzicion. Siç ndodh në këto raste, është niveli më i ulët i institucionalizimit të sistemit partiak që është kryesisht përgjegjës për ndryshimet e mëdha elektorale viteve të fundit, duke përfshirë suksesin dramatik të disa partive të reja. Për më tepër, gatishmëria gjithnjë në rritje dhe e dukshme e elektoratit të Kosovës për t'i ndëshkuar ata që janë në pushtet kanë bërë që të zbehet mbështetja për dy partitë dominuese në Kosovë, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). Kjo është një shenjë e rritjes së pjekurisë demokratike të votuesve kosovarë. Si rezultat, studimi arrin në përfundimin se as jetëgjatësia e shkurtër e qeverive, e as paqëndrueshmëria e dukshme zgjedhore nuk paraqesin kërcënime për konsolidimin e demokracisë së re në Kosovë.

Studimi ngre paralajmërimet për trendet e përsëritura ndaj krizës politike që kanë pasuar zgjedhjet e vitit 2014 dhe së fundmi ato të vitit 2017. Në secilin rast, partitë dhe koalicionet që kanë mungesë të shumicës, por që mbajnë

shumicën e vendeve në parlament, kanë bllokuar efektivisht procesin e formimit të qeverisë duke u mbështetur në defekte procedurale të parashikuara në Kushtetutën e Kosovës. Këto defekte qëndrojnë në veçanti në Nenin 67 të Kushtetutës së Kosovës dhe në interpretimin e saj nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës me një aktvendim në vitin 2014. Ky nen e rregullon procedurën me të cilën një Kuvend i sapokrijuar zgjedh kryetarin e Kuvendit pas zgjedhjeve. Meqenëse formimi i qeverisë varet nga aftësia e Kuvendit për të ardhur deri te përbërja e plotë, duke ia dhënë të drejtën e nominimit të Kryetarit të Kuvendit ekskluzivisht partisë me më së shumti vende, Kushtetuta ka paraparë instrumentin për partinë apo koalicionin shumicë për të përmirësuar pozicionin e saj/tij negociues duke pretenduar të drejtën ekskluzive për të formuar qeverinë. Duke treguar se si kjo praktikë qëndron në kundërshtim me praktikën normale demokratike dhe parimet demokratike, raporti nënvizon nevojën për reformë kushtetuese, që do ta ndryshonte nenin 67 qoftë duke i rishikuar rregullat sa i përket mënyrës që do t'ia lejonte cilësdo parti që të nominonte Kryetarin e Kuvendit ose duke e shuar këtë dispozitë tërësisht nga Kushtetuta dhe transferimin e rregullave në rregulloren e brendshme të Kuvendit. Siç edhe potencohet në këtë studim, kjo do të bënte që procedurat e Kosovës të jenë në përputhje me praktikën në shumicën e demokracive parlamentare të Evropës.

Studimi tërheq vëmendjen në nevojën që partitë të bashkëpunojnë për ndërtimin e përbashkët të kulturës demokratike të normave joformale të nevojshme për t'i rregulluar proceset e rëndësishme gjatë transicionit të pushtetit. Duke qenë se PDK-ja vazhdimisht ka qenë në pushtet që nga pavarësia e Kosovës, Kosova ende nuk ka përjetuar një transfer të plotë të pushtetit ku një parti në pushtet heq dorë nga kontrolli i qeverisë. Studimi tërheq vëmendjen edhe në nevojën për më shumë kapacitete politikëbërëse brenda partive politike për t'i orientuar

negociatat mbi formimin e koalicionit drejt qëllimeve programore dhe drejtimeve të politikave, për dallim nga ndarja e plaçkës së pushtetit politik, siç ka qenë trendi në vitet e fundit.

Hyrje

Zgjedhjet nacionale në Kosovë të vitit 2017 zbuluan tri gjëra rreth evolucionit të demokracisë së re të Kosovës. Së pari, se deri më tani, qeveritë e Kosovës vazhdojnë të jenë jetëshkurtra, pa asnjë qeveri që nga pavarësia të ketë përfunduar mandatin e saj të plotë pa iu nënshtruar zgjedhjeve të parakohshme. Së dyti, se votuesit në Kosovë duken të jenë më pak të gatshëm t'i mbështesin partitë në pushtet në nivel nacional. Së fundi, se, sikurse në vitin 2014, demokracia e re e Kosovës është e prirë ndaj krizave institucionale, me politikën e vendit që vjen deri tek një paralizë e plotë, pasi që partitë ose nuk janë në gjendje të negociojnë me sukses për formimin e një koalicioni në pushtet, ose se partia apo koalicioni dominues gëzon një fuqi të veçantë të vetos ndaj çdo koalicioni pas-zgjedhor ku nuk është e/i përfshirë vetë.

A janë këto procese të dëmshme për zhvillimin demokratik të Kosovës? Ky raport argumenton se proceset e para dhe të dyta nuk përbëjnë rrezik serioz për demokracinë e Kosovës dhe duhet të shihen si tipare normale të politikës demokratike. Për dallim nga ato, bllokada politike e institucioneve qeverisëse pas zgjedhjeve paraqet rreziqet më të mëdha sa i përket legjitimitetit dhe konsolidimit të sundimit demokratik në Kosovë. Megjithatë, ky problem është i ndreqshëm dhe kërkon trajtimin e një numri të metash në përmbajtje dhe interpretimin e Kushtetutës së Kosovës.

Në këtë raport diskutohet mbi tri çështjet e përshkruara gjerësisht më lart. Në çështjen e mandatit dhe stabilitetit të qeverisë, ai mbështetet në një numër masash krahasuese për të treguar se vetëm paqëndrueshmëria qeveritare në sistemet parlamentare nuk e kërcënon demokracinë. Megjithatë, ajo që mund të jetë një rrezik për demokracinë e brishta është se ndryshimet e shpeshta në qeveri mund të

çojnë në dobësi të politikave dhe në dobësimin e efektivitetit të qeverisë në trajtimin e problemeve thelbësore të transformimit social dhe ekonomik. Ky rrezik potencial dhe rreziqet që ai i mbart diskutohen deri në një farë mase. Sa i përket paqëndrueshmërisë zgjedhore, në raport paraqiten masat krahasuese të paqëndrueshmërisë, duke e krahasuar Kosovën me pjesën tjetër të rajonit. Në raport argumentohet se natyra e paqëndrueshmërisë zgjedhore në vetvete nuk paraqet kërcënim për demokracinë, duke pasur parasysh stabilitetin themelor të sistemit partiak. Ajo çfarë Kosova ende nuk e ka përjetuar që nga pavarësia është transferimi i pushtetit që përfshin partinë dikur më dominuese të Kosovës, Partinë Demokratike të Kosovës (PDK), që ajo të heqë dorë nga prania e saj në qeveri. Në fund, diskutimi kthehet tek çështja e krizave institucionale pas zgjedhjeve. Aty argumentohet se sa urgjent është trajtimi i këtij problemi relativisht të ndreqshëm në mënyrë konsensuale. Meqenëse mekanizmat kushtetues që lejojnë partinë dominuese zgjedhore të bllokojë formimin e një qeverie të re fillojnë vetëm pas zgjedhjeve (dhe vetëm atëherë kur partia dominuese dështon në gjetjen e aleatëve qeverisës), kjo çështje harrohet lehtë pas formimit të qeverive. Duke pasur parasysh se rregullat që u lejojnë partive t'i bëjnë bllokimet e tilla nuk janë as në përputhje me parimet demokratike, e as me praktikat normale të demokracisë parlamentare, me këtë rrezikohet që të lindin kushte për sjellje arbitrare që e minojnë besimin e publikut në procesin politik dhe në institucionet e zgjedhjeve.

Historiku i zhvillimit demokratik të Kosovës që nga pavarësia

Kushtetuta e Kosovës e pas pavarësisë e miratuar në vitin 2008 e përcakton Kosovën si demokraci parlamentare me Kuvend njëdhomësh, me 120 vende të zgjedhura përmes sistemit proporcional me lista të hapura. 20 vende janë të garantuara për partitë që i përfaqësojnë pakicat etnike (jo-shqiptare), prej të cilave dhjetë vende janë të garantuara për partitë e pakicës serbe. Kushtetuta parasheh ndarjen e pushtetit legjislativ dhe gjyqësor ndërmjet Kuvendit dhe gjyqësorit të pavarur. Pushteti ekzekutiv mbetet tek qeveria që zgjedhet dhe i jep llogari Kuvendit. Kushtetuta gjithashtu përcakton një udhëheqës apolitik në figurën e Presidentit, i cili zgjidhet nga Kuvendi me një mandat pesëvjeçar.

Si një rast i demokratizimit, Kosova ka pak vende homologe për krahasim, të paktën në Evropë. Si një rajon dhe shtet i ri që doli nga shpërbërja e një regjimi të udhëhequr nga komunistët, Kosova ndan disa veçori me vendet e tjera post-komuniste të Evropës. Por, ajo është po ashtu pjesërisht e dallueshme në atë që shteti dhe regjimi i saj demokratik dolën nga një periudhë e represionit të ashpër, konfliktit të dhunshëm etnik dhe përpjekje të gjera ndërkombëtare për ndërtimin e shtetit (Skendaj 2014, Pula 2003). Ndonëse trashëgimia e kësaj të kaluarë është e rëndësishme, kur bëhet fjalë për formimin dhe shpërbërjen e qeverisë, loja politike demokratike në Kosovë përgjithësisht ka ndjekur parime të ngjashme sikurse në demokracitë e tjera. Zgjedhjet e fundit kanë qenë relativisht të lira nga shtrembërimet e mëdha, presioni, mashtrimi dhe dhuna¹.

1 Shih, p.sh., “Zgjedhjet vërtet konkurruese në pjesën më të madhe të Kosovës por vullneti politik duhet t’i adresojë dobësitë afatgjata, dhe frikësimin në zonat me serb të Kosovës,” Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve i Bashkimit Evropian – Kosova 2017. Gjendet në https://eeas.europa.eu/election-observation-missions/eom-kosovo-2017/28080/elections-genuinely-competitive-most-kosovo-political-ëill-needed-address-long-standing_en (për herë të fundit e parë më 15

Ndërsa aktorët e jashtëm mund të luajnë një rol prapa skenës gjatë fazave negociuese të formimit të qeverisë, ndikimi i drejtpërdrejtë i misioneve ndërkombëtare në politikën e Kosovës me kalimin e kohës është zvogëluar. Në të njëjtën kohë, vëzhguesit e pavarur kanë shprehur shqetësime rreth drejtimit që ka marrë zhvillimi demokratik i Kosovës. Për shembull, Freedom House i jep Kosovës vlerësime të ulëta në masat e të drejtave politike dhe e karakterizon Kosovën si një “qeveri kalimtare apo regjim hibrid”, i cili është një hap larg nga një demokraci gjysmë ose plotësisht e konsoliduar². Në vitet e fundit, vendi ka shfaqur tendenca autoritare alarmante, të tilla si burgosja e liderëve opozitar, si dhe frikësimi dhe dhuna kundër gazetarëve të pavarur. Megjithatë, sistemi politik vazhdon të mbetet relativisht i hapur dhe konkurrues.

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), administrata civile e krijuar në Kosovë pas konfliktit në vitin 1999 sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, mori një rol shumë më të reduktuar dhe më marginal. Në anën tjetër, Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX) vazhdon me punën e vet që nga themelimi i tij në vitin 2008 dhe roli i tij është i kufizuar në ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe në aktivitetet e zbatimit të ligjit dhe është më pak i përfshirë në çështjet e përditshme politike të Kosovës. Në shtator të vitit 2012, Grupi Drejtues Ndërkombëtar po ashtu e përfundoi pavarësinë e mbikëqyrur të Kosovës me mbylljen e Zyrës Civile Ndërkombëtare (ICO). ICO që krijuar në bazë të marrëveshjes së Ahtisaarit me mandatin që të mbikëqyret zbatimin i saj nga autoritetet e Kosovës, duke pasur edhe

nëntor 2017).

² Shih shënimin mbi Kosovën në Raportin “Liria në Botë” 2018 të Freedom House (<https://freedomhouse.org/report/freedom-eorld/2018/kosovo>) dhe Kombet në Tranzicion(<https://freedomhouse.org/report/nations-transit/nations-transit-2018>).

kompetencat e vetos në rastet kur autoritetet e Kosovës do të vepronin në kundërshtim me dispozitat e saj. Gjersa pesë anëtarët e Grupit të Kontaktit (Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar, Franca, Gjermania dhe Italia), e veçanërisht Shtetet e Bashkuara, vazhdojnë të ushtrojnë ndikim të fortë mbi proceset dhe aktorët politik në Kosovë nëpërmjet ambasadorëve të tyre lokalë, ata nuk kanë shkuar aq thellë sa ta urdhërojnë rënien e qeverive.

Që nga largimi i ICO-së Kosova ka mbajtur dy palë zgjedhesh nacionale (2014 dhe 2017) dhe dy palë zgjedhesh komunale (2013 dhe 2017). Ndonëse kishin të meta në disa aspekte, vetë zhvillimi i zgjedhjeve ishte relativisht i rregullt dhe sistemi zgjedhor e ka ruajtur faktin se ai është relativisht i hapur. Në të vërtetë, vetë fakti i paqëndrueshmërisë së qeverisë dhe kërcënimet në rritje ndaj partive dominuese në pushtet janë tregues i mjaftueshëm që asnjë parti në pushtet nuk ka qenë në gjendje ta monopolizojë plotësisht sistemin politik dhe aparatit administrativ të porsa-krijuar të shtetit në atë masë sa të bënte garën në zgjedhje të pakuptimtë³. Me faktin se asnjë parti e vetme nuk ka dominuar politikën e Kosovës në kuptimin e plotë të shumicës, proceset e ndërtimit të koalicionit dhe formimit të koalicionit janë bërë jetike për sistemin politik të Kosovës. Megjithatë, që nga viti 2014, ky proces është bërë gjithnjë e më i stërngarkuar dhe i priorë ndaj krizave institucionale. Diskutimi vijues shqyrton proceset e formimit të qeverisë në Kosovë gjatë viteve 2014

3 PDK, partia dominuese që nga viti 2008, ka pasur ndikim të madh mbi aparatit shtetëror në Kosovë, duke përfshirë emërimet e militantëve partiak në polici, gjyqësor, ndërmarrje publike dhe agjenci të pavarura, siç zbulojnë hulumtimet dhe raportimet nga gazetarët e pavarur (shih, për shembull, hulumtimet nga Preportr [http://preportr.cohu.org], Insajderi [http://www.insajderi.com] dhe gazeta e përditshme Koha Ditore). Megjithatë, shtrirja e PDK-së nuk ka qenë aq e thellë dhe e gjerë sa ta çojë Kosovën në drejtim të shtetit partiak plotësisht autoritar ose ajo çfarë Way dhe Levitsky (2010) e definojnë si një regjim "autoritar konkurrues", në të cilin ata që janë në pushtet gëzojnë kontroll të gjerë mbi shtetin, ekonominë dhe mediat në atë mënyrë që e pengojnë konkurrencën politike domethënëse.

dhe 2017 për të demonstruar problemet me të cilat ballafaqohen aktorët politikë në procesin e ndërtimit të koalicionit dhe të formimit të qeverisë.

Teposhtëzja rrëshqitëse? Kohëzgjatja e qeverisë dhe paqëndrueshmëria zgjedhore

Disa vrojtues shprehin shqetësimin se qeveritë e Kosovës janë tepër jetëshkurtra. Është e vërtetë se asnjë qeveri që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008 nuk e ka përfunduar asnjë mandat të plotë (4 vjeçar) në detyrë siç parashihet me Kushtetutën e Kosovës. Kritikët theksojnë se kjo e minon kapacitetin e qeverive për të zbatuar qëllimet kryesore të politikave dhe reformat, me kalimin e kohës në pushtet. Ata gjithashtu e interpretojnë këtë si shenjë të paqëndrueshmërisë politike - dhe të mundësisë për jo stabilitet të thellë institucional. Megjithatë, këto nuk janë domosdoshmërisht të vërteta - dhe në të vërtetë, mund të jenë shenja të një sistemi demokratik me bazë elektorale që po maturohet.

Shkencëtarët politik e pranojnë se, nëpër demokraci, ekziston një ndarje bazë ndërmjet sistemeve presidenciale dhe parlamentare sa i përket stabilitetit qeveritar (Lijphart 1999, Linz 1994). Sistemet presidenciale priren të kombinohen me sistemet elektorale mazhoritare, që ofrojnë udhëheqje më të qëndrueshme dhe afatgjata⁴. Për dallim nga kjo, sistemet parlamentare janë subjekt i paqëndrueshmërisë më të madhe politike dhe, kështu, qeveritë priren të jenë më pak stabile dhe më jetëshkurtëra. Kjo është veçanërisht e vërtetë, pasi sistemet proporcionale

4 Linz (1994) dhe të tjerët argumentojnë se, në vendet në zhvillim, sistemet presidenciale kanë qenë më kërcënuese për demokracinë dhe ka më shumë gjasa të çojnë drejt një qeverie autoritare. Argumente të ngjashme janë dhënë për shtetet post-komuniste (Way dhe Levitsky 2010). Kjo është një çështje që megjithatë mbetet përtej fushëveprimit të këtij studimi. Për të shmangur komplikime të tilla, rastet tona të referimit janë gjithmonë relativisht të konsoliduara dhe regjime të qëndrueshme demokratike.

të zgjedhjeve krijojnë potencial për më shumë fragmentim të partive dhe se formimi i qeverive mbështetet në aftësinë e udhëheqësve partiakë për të krijuar koalicione me të tjerët.

Duke pasur parasysh strukturën parlamentare të sistemit demokratik të Kosovës, përdorimi i sistemit zgjedhor proporcional dhe një sistemi partiak që ka pësuar paqëndrueshmërinë relative që nga pavarësia, ekzistenca e qeverive jetëshkurtëra nuk është një zhvillim i habitshëm. Në të vërtetë, të dhënat krahasuese tregojnë se qeveritë me jetë të shkurtër janë normë në shumicën e demokracive parlamentare. Duke përdorur këta tregues krahasues, qeveritë e kaluara të Kosovës kanë pasur mandate *më të gjata* se qeveritë mesatare në të dyja llojet e vendeve të Evropës, si ato të konsoliduara ashtu edhe ato në transicion. Tabela 1 tregon kohëzgjatjen mesatare të qeverive në Evropën Perëndimore, në Evropën Qendrore dhe Lindore. Kur mesatarja e Evropës Perëndimore prej 636.7 ditësh dhe mesatarja më e shkurtër e Evropës Qendrore dhe asaj Lindore prej 582.5 krahasohet me kohëzgjatjen mesatare të qeverive të Kosovës (që nga viti 2008) që zgjat 1.178 ditë, del se qeveritë e Kosovës janë mjaft jetëgjata. Një klasifikim sa i përket ditëve në detyrë për qeveritë në detyrë që nga viti 2008 është dhënë në figurën 1.

Sidoqoftë, të dhënat krahasuese tregojnë variacion të madh midis vendeve si Italia, ku qeveritë mesatare zgjasin më pak se një vit dhe Irlanda, me një mesatare më të lartë prej 935 ditësh. Duke pasur parasysh këtë, mund të shtrohet pyetje se pse vendet me sisteme të ngjashme politike tregojnë një variacion kaq të madh, me disa që priren të kenë qeveri më jetëshkurtëra se të tjerat. Shkencëtarët politik kanë ofruar një numër shpjegimesh të përgjithshme të përcaktuesve të kohëzgjatjes së qeverisë në demokracitë parlamentare. Një shpjegim i qartë lidhet me shkallën e fragmentimit të sistemit partiak. Historikisht, qeveritë më të qëndrueshme në sistemet parlamentare kanë qenë ato të udhëhequra dhe

të plotësuar me staf nga një parti e vetme. Kjo, sigurisht, nënkupton që një parti e vetme fiton një shumicë të qartë parlamentare dhe se udhëheqja ushtron kontroll të mjaftueshëm disiplinor mbi deputetët e saj. Por kështu ndodh rrallë në shumicën e sistemeve parlamentare, ku qeverisja nga një koalicion praktikisht përbën normë. Fragmentimi e bën formimin e koalicionit më të vështirë, veçanërisht nëse partitë ndahen sa u përket orientimeve themelore ideologjike ose në politika. Si rezultat, sa më i fragmentuar të jetë sistemi partiak, aq më e vështirë është për udhëheqësit e partive të krijojnë koalicione të qëndrueshme që zgjasin (më së shumti) për një mandat të plotë në detyrë.

Sapo të vijë në pushtet, stabiliteti i një qeverie mund të varet nga numri i partive të përfshira në koalicionin qeverisës. Sa më i madh të jetë numri i partive të akomoduar në një koalicion qeverisës, aq më shumë ka të ngjarë të ketë mosmarrëveshje të mundshme mbi politikat që mund të çojnë një partner kyç të koalicionit të tërhiqet, duke e lënë qeverinë me mbështetje të pamjaftueshme parlamentare. Një alternativë tjetër është që partitë të formojnë qeveri të pakicës, në të cilat një parti kryesore ose një grup i partive vendosin të mbështesin një qeveri edhe nëse nuk i bashkohen kabinetit qeveritar. Një e treta e të gjitha qeverive në Evropën Perëndimore, Qendrore dhe Lindore kanë qenë qeveri të pakicës, që sugjeron se kjo nuk është një praktikë e pazakontë në demokracitë parlamentare (Keudler-Kaiser 2016). Në të njëjtën kohë, qeveritë e pakicës mund të jenë më pak të qëndrueshme, pasi që në çdo kohë aleatët parlamentarë mund të bashkohen me opozitën për ta “tërhequr nga priza” një qeveri. Një problem që ndërlidhet dhe është në kontrast me këtë është ai që është identifikuar nga Dodd (1976), që ai e quan “qeveria e tepricës”. Ato kanë në përbërjen e vet më shumë parti se sa që janë të nevojshme për të qeverisur, gjë që e redukton fuqinë dhe resurset e disponueshme për anëtarët e koalicionit, duke i

detyruar partitë anëtare ta “ndajnë piten” e pushtetit politik në pjesë gjithnjë e më të vogla. Qeveritë e tepricës i nënshtrohen shantazhit politik nga brenda, pasi partitë anëtare kërkojnë që të detyrojnë shkuarjen në zgjedhje për të përmirësuar pozicionin e tyre, si dhe për të nxjerrë partitë e panevojshme nga koalicioni.

Europa Perëndimore		Europa Qendrore dhe Lindore	
Shteti	Kohëzgjatja (Ditë)	Shteti	Kohëzgjatja (Ditë)
Italia	251.0	Letonia	330.7
Finlanda	319.1	Rumania	269.9
Belgjika	450.4	Lituania	446.9
Danimarka	578.5	Polonia	449.1
Holanda	649.7	Estonia	476.9
Gjermania	671.0	Bullgaria	590.0
Suedia	744.6	Slovakia	593.0
Norvegjia	752.7	Slovenia	603.7
Austria	800.6	Republika Çeke	869.5
Mbretëria e Bashkuar	850.2	Hungaria	1095.7
Irlanda	935.0		
Mesatarja	636.7	Mesatarja	582.5

Tabela 1. Kohëzgjatja mesatare e qeverisë në Evropën Perëndimore, Qendrore dhe Lindore. Burimi: Somer-Topcu dhe Williams 2008.

Nëpërmjet një analize sasiore të demokracive në tranzicion të Evropës Qendrore dhe Lindore, një studim i Somer-Topcu dhe Williams (2008) konstaton se raporti i rrezikut që shpreh mundësinë për rënien e qeverisë, rritet nga numri i partive në qeveri. Siç pritet, më të prekshme për t'u rrëzuar janë qeveritë e pakicës, ndërsa qeveritë e shumicës janë më të qëndrueshme. Ata gjejnë më pak dëshmi sa i përket ndikimit të qeverisë së tepricës, me jetëgjatësinë e këtyre

qeverive që është më gjatë se të tjerat dhe lë pas vetëm qeveritë e shumicës. Ata gjithashtu gjejnë prova të konsiderueshme se gjërat si paqëndrueshmëria ekonomike, rritja e papunësisë dhe inflacioni, i bëjnë qeveritë më të prira për të rënë. Në përgjithësi, ata zbulojnë se qeveritë janë të prirura më shumë për të rënë pas vitit të tyre të dytë në detyrë dhe shkalla e rrezikshmërisë rritet ndjeshëm për qeveritë e kontrolluara nga më shumë se dy parti.




Figura 1. Kohëzgjatja e qeverisë në Kosovë që nga viti 2008 (numri i ditëve në detyrë, ditët në detyrë përfshijnë periudhën e qeverisë në largim mes datës së humbjes së mbështetjes parlamentare, zgjedhjeve dhe datës së formimit të një qeverie pasuese).

Modelet e përgjithshme të vërejtura në analizat krahasuese Somer-Topku dhe Williams kanë dhënë rezultate relativisht të mira për Kosovën. Për të shqyrtuar rëndësinë e këtyre shkaqeve, raporti do të kthehet në diskutimin e rastit për shkaqet që kanë qëndruar prapa rënies së qeverive Thaçi I, Thaçi II dhe Mustafa në vitet 2011, 2014 dhe 2017. Ndonëse studimet e rasteve dhe analizat sasiore bazohen në supozime të ndryshme metodologjike, gjetjet e përgjithshme sasiore të përshkruara më lart mund të shërbejnë si bazë për shqyrtimin e shkaqeve të kolapsit të hershëm të qeverive të Kosovës përmes një analize cilësore (Gerring 2007, Mahoney 2008, Goertz dhe Mahoney 2012).

Qeveria Thaçi I, 2008-11

Qeveria e parë e kryeministrit Hashim Thaçi u formua në vitin 2008, krahas procesit të negociatave për statusin e Kosovës nën drejtimin e ish-presidentit finlandez Marti Ahtisaari. Deri në atë pikë, Kosova u udhëhoq nga ajo që konsiderohej kryesisht një qeveri kujdestare nën udhëheqjen e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në koalicion me Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK). Koalicioni midis LDK-së dhe AAK-së, një parti shumë më e vogël, u formua në vitin 2004. Marrëveshja përfshinte një aranzhim për ndarjen e pushtetit në të cilën udhëheqësi i LDK-së, Ibrahim Rugova do të zgjidhej president në këmbim të mbështetjes së LDK-së për një qeveri të udhëhequr nga kreu i AAK-së, Ramush Haradinaj, ish-komandant i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) për rajonin e Dukagjinit në Kosovën perëndimore.

Qëndrimi i Haradinajt në pushtet ishte i shkurtër, duke marrë parasysh aktakuzën e tij nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë (TPNJ) në Hagë për krime të pretenduara të luftës, shumë shpejt pas emërimit të tij. Pas dorëzimit të Haradinajt në Tribunal, qeveria u pasua nga një sërë udhëheqjesh të dobëta nga vartësit e Haradinajt në AAK⁵. Në vitin 2006, me fillimin e procesit të negocimit të statusit, qeveria u vu nën udhëheqjen e Agim Çekut, një ish-gjeneral i ushtrisë jugosllave dhe shef i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së në vitin 1999.

Me Kosovën ende nën administrimin e UNMIK-ut, qeveritë e para vitit 2008 kishin një rol shumë më të kufizuar në qeverisje dhe funksioni i tyre kryesor ishte ndërtimi i konsensusit për shtet ndërtim me ndërkombëtarët, menaxhimi i konflikteve të brendshme midis fraksioneve

⁵ Haradinaj u gjykuar dhe u lirua nga të gjitha akuzat në prill të vitit 2008. Rasti i tij u rigjykuar dhe Haradinaj u shpall i pafajshëm për herë të fundit nga TPNJ-ja në vitin 2012.

rivale politike të Kosovës si dhe ruajtja e unitetit politik gjatë negociatave për statusin e Kosovës. Qeveria AAK-LDK gjithashtu kishte një rol të kufizuar në negociatat për statusin, që udhëhiqeshin nga një Grup Uniteti i formuar enkas dhe i përbërë nga të gjitha partitë parlamentare, përfshirë Partinë Demokratike të Kosovës (PDK) të udhëhequr nga Thaçi dhe ORA-n që kryesohej nga Veton Surroi. Sapo negociatat për statusin iu afruan përfundimit të tyre, kreu i UNMIK Joachim Ruecker caktoi zgjedhjet parlamentare për në nëntor të vitit 2007. Ndonëse LDK ishte partia dominuese në Kosovë, udhëheqësi i saj Rugova po vuante nga sëmundja dhe vdekja e tij në vitin 2006 i dha një goditje të rëndë popullaritetit të partive, si dhe shkaktoi ndarje të brendshme. Si rezultat i kësaj, PDK e Thaçit mori 34 përqind të votave dhe doli si partia kryesore.

Duke qëndruar në temën e përgjithshme të unitetit politik kur Kosova hyri në fazën e saj të shtetësisë, Thaçi bëri lëvizjen e papritur të krijimit të një koalicioni me LDK-në. Deri atëherë, të dy partitë ishin parë si rivalët më të mëdhenj në politikën e Kosovës. Thaçi shihet gjithashtu si ndëshkues i AAK-së për aleancën e saj të papritur me LDK-në në vitin 2004. Në këmbim të mandatit të Thaçit si kryeministër, PDK mbështeti zgjedhjen e Fatmir Sejdiut të LDK-së si President i Kosovës. Në kombinim, koalicioni PDK-LDK la një opozitë të dobët në AAK, Aleancën e sapokrijuar për Kosovën e Re (AKR) që u formua nga biznesmeni Behgjet Pacolli, dhe partinë e ndarë nga LDK-ja, Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD), që së bashku kishin një të tretën e vendeve në parlament.

Koalicioni PDK-LDK qeverisi deri në rrëzimin e tij në vitin 2010. Rënia erdhi nga një aktvendim i Gjykatës Kushtetuese që thoshte se me mbajtjen në të njëjtën kohë nga ana e Sejdiut të presidencës dhe të postit të kryetarit të LDK-së kishte shkelur kushtetutën, e cila ia ndalonte Presidentit që njëkohësisht të mbante postet e tjera politike. Vendimi i

Gjykatës e detyroi Sejdiun të largohej nga presidenca. Thashethemet dhe raportet e pakonfirmuara treguan se largimi i Sejdiut ishte orkestruar nga PDK, aleatët e të cilëve u ulën në karriget e Gjykatës Kushtetuese. Sidoqoftë, vendimi i Gjykatës i zemëroi anëtarët kryesorë të LDK-së, duke rezultuar në vendimin e partisë për të ndërprerë koalicionin e saj me PDK-në. Zgjedhjet e papritura të parakohshme u caktuan për në dhjetor të vitit 2010.

Qeveria Thaçi II, 2011-14

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2010 rezultuan në atë që PDK-ja ruajti epërsinë e saj si parti dominuese, duke fituar 32 përqind të votave në nivel vendi. Ndërsa zgjedhjet u dëmtuan nga akuzat për mashtrim, duke çuar në përsëritjen e zgjedhjeve në një numër zonash, ato rezultuan në formimin e një koalicioni të ri midis PDK-së dhe AKR-së, si dhe një numri partish të vogla. Ashtu sikurse me LDK-në, marrëveshja përfshinte një marrëveshje për ndarjen e pushtetit ku udhëheqësi i AKR-së Pacolli do të zgjidhej President dhe Thaçi do të vazhdonte si kryeministër. Marrëveshja u zbatua, por një ankesë e LDK-së dhe e partive të tjera opozitare ushtroi ankesë në Gjykatën Kushtetuese lidhur me zgjedhjen e Pacollit si President. Gjykata e rrëzoi zgjedhjen e Pacollit si të parregullt për shkak të mungesës së kuorumit të nevojshëm në parlament gjatë procedurës së votimit (LDK dhe pjesa tjetër e opozitës e bojkotuan seancën gjatë së cilës u zgjodh Pacolli).

Ky ndërlikim nuk rezultoi me tërheqjen e AKR-së nga koalicioni, me partinë që po vazhdonte dhe Pacolli u emërua si zëvendëskryeministër⁶. Megjithatë, pakënaqësia në rritje me punën e qeverisë, duke përfshirë një numër dështimesh

6 Në fund, Atifete Jahjaga, një ish-zyrtare e lartë e policisë dhe një e panjohur në politikë, u zgjodh Presidente. Kandidatura e Jahjagës u ofrua si një zgjedhje dhe e mbështetur nga ambasadori amerikan Christopher Dell si një zgjidhje “kompromisi” për bllokadën politike të zgjedhjes së presidentit.

në frontin ndërkombëtar (përfshirë liberalizimin e vizave me BE-në) dhe fillimin e negociatave të vështira dhe politikisht të kushtueshme me Serbinë nën patronazhin e BE-së, e çuan Thaçin dhe PDK-në drejt ndjenjës së të qenit gjithnjë e më pak të angazhuar ndaj qeverisë së koalicionit. Duke u përballur me nevojën për një mandat të ripërtërirë politik, PDK-ja e sajoi rënien e vet duke negociuar me opozitën LDK-në dhe AAK-në (opozita e re dhe e zëshme parlamentare [Lëvizja Vetëvendosje – LV] nuk ishte pjesë e këtyre negociatave)⁷. Ndonëse Pacolli dhe partia e tij AKR e kundërshtuan shpërbërjen e qeverisë në të cilën ata ishin pjesë, partia e tij ishte shumë e dobët për t'i ndaluar negociatat dhe mund të bënte pak, por vetëm të shikonte se si partneri më i madh qeverisë po punonte për të rrëzuar qeverinë e vet. Negociatat e PDK-së me opozitën rezultuan në atë që AAK-ja të propozonte një mocion mosbesimi ndaj qeverisë në Kuvendin e Kosovës në maj të vitit 2014. Mocioni kaloi me mbështetjen e deputetëve të PDK-së, LDK-së dhe AAK-së.

Ndryshe nga rënia e qeverisë e vitit 2011 që ishte produkt i thyerjes së kompaktësisë politike ndërmjet PDK-së dhe LDK-së, shpërbërja e vitit 2014 u iniciua nga vetë partia në pushtet. Ndërsa motivet e sakta për vendimin e Thaçit për të zhbërë koalicionin dhe për të thirrur zgjedhje të parakohshme nuk janë plotësisht të njohura, është e qartë nga sjellja e tij dhe e PDK-së në kohën kur ata besonin se vazhdimi i koalicionit me Pacollin dhe AKR-në ishte politikisht i dëmshëm. Thaçi dhe lidërsi i PDK-së kanë llogaritur gjithashtu se duke thirrur zgjedhje të parakohshme, ata mund t'i kontestonin ata nga pozitat e fuqishme, në vend që të lejonin rritjen e mbështetjes për turrje, pasi pritjet popullore mbi performancën e qeverisë

⁷ “Mocioni i votëbesimit për rrëzimin e Qeverisë javën e ardhshme, thotë Gjini,” KosovoLive, 14 shkurt 2014. Gjetet në <http://www.kosovalive360.com/mocioni-i-votbesimit-per-rrzezimin-e-qeverise-javen-e-ardhshme-thote-gjini.html> (për herë të fundit e parë më 14 nëntor 2017).

u rritën jashtëzakonisht pas pavarësisë, ndërkohë që ekonomikisht dhe politikisht vendi po stagnonte. Në të njëjtën kohë, akuzat për korrupsion dhe abuzime në nivelet e larta të qeverisjes u përhapën gjithnjë e më shumë nga opozita, mediat e pavarura, aktorët ndërkombëtarë dhe vëzhguesit joqeveritarë, duke dëmtuar më tej bazën në dukje të gjerë të mbështetjes popullore që PDK gëzonte në vitin 2007⁸. Hyrja e LV-së në parlament në vitin 2010 gjithashtu futi në Kuvend një opozitë më të zëshme që ishte më pak e gatshme për negociim dhe kompromis, duke i komplikuar procedurat parlamentare dhe duke e kthyer Kuvendin gjithnjë e më shumë në një arenë të akuzave dhe të polemikave të pazbukuruara dhe jo siç ishte Kuvendi për shumicën e viteve 2000 një organ që shërbente vetë si vulë – gome kryesisht ritualiste (nën UNMIK-un dhe qeverinë e parë të Thaçit).

8 Ndonëse akuzat për korrupsion në të gjitha nivelet e qeverisë u bënë mbizotëruese në mediat kosovare, disa raste të profilit të lartë që e dëmtuan periudhën e Thaçit në qeveri janë me vlerë të nënvizohen. Në vitin 2009, Nazmi Bllaca pretendonte se ishte një ish-operativ i SHIK-ut, i shërbimit informativ klandestin të PDK-së dhe se kishte kryer një numër vrasjesh të motivuara politikisht nën urdhrat e zyrtarëve të lartë të PDK-së. Bllaca u bë dëshmitar i mbrojtur dhe çështja e tij çoi në një numër hetimesh dhe gjykimesh nga EULEX-i që janë ende në vazhdim e sipër (Shih, mes tjerash, “Nazim Bllaca, i vetëquajturi vrasës i Kosovës: ‘Nuk jam i Çmendur’, “Drejhtësia Transicionale në Ballkan, 29 nëntor 2011 [<http://www.balkaninsight.com/en/article/nazim-bllaca-kosovo-self-styled-assassin-i-m-not-mad>]; “lidhjet e pretenduara ndërmjet politikanëve të lartë të Kosovës dhe vrasësit të hetuar,” The Guardian, 7 nëntor 2014 [<https://www.theguardian.com/world/2014/nov/07/kosovo-hitman-inquiry-eulex-hashim-thaci>]). Në vitin 2010, Fatmir Limaj, që kishte shërbyer si Ministër i Transportit dhe i Infrastrukturës i PDK-së, u akuzua për përvetësim të fondeve publike. Rasti Limaj përfshinte edhe një kontratë ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe konsorciumit Bechtel-Enka për ndërtimin e një autostrade prej 1 miliard dollarësh që e lidh Kosovën me Shqipërinë, një nga projektet e këtij lloji më e shtrenjta në Ballkan dhe detajet e të cilave nuk u zbuluan publikisht. Në vitin 2016, publikimi publik i regjistrimeve të bisedave telefonike sekrete mes anëtarëve të nivelit të lartë të PDK-së zbuloi një prej anëtarëve të lartë të PDK-së, Adem Grabovcin, si figurë kyçe që orkestronte emërimin e militantëve të PDK-së në pozita të larta në tërë gjyqësorin, ndërmarrjet publike dhe pavarura.

Qeveria Mustafa, 2014-17

Rrethanat që çuan në rënien e qeverisë Mustafa në vitin 2017 ishin të ngjashme me atë të qeverisë Thaçi II. Koalicioni i përtërirë PDK-LDK u krijua në 2014 pas një periudhe të konsiderueshme të bllokadës institucionale dhe të pasigurisë pas zgjedhjeve të vitit 2014⁹. Në vitin 2016, Thaçi u largua nga qeveria, ku ai kishte shërbyer si zëvendës kryeministër dhe ministër i Punëve të Jashtme, për t'u bërë President. Zgjedhja e tij ishte në përputhje me marrëveshjen e koalicionit PDK-LDK që përcaktonte se në këmbim të udhëheqjes së qeverisë, LDK do të mbështeste zgjedhjen e Thaçit në presidencë si pasardhës i Presidentes Atifete Jahjaga. Pas zgjedhjes së tij në presidencë, Thaçi dha dorëheqjen nga pozita në partinë e tij, duke e lënë misionin e tij të kohës së luftës dhe aleatin Kadri Veseli, ish-drejtues i organizatës së fshehtë të grumbullimit të informatave të PDK-së SHIK (Shërbimi Informativ i Kosovës). Duke shërbyer si Kryetar i Kuvendit të Kosovës, Veseli pati një ndikim të kufizuar mbi qeverinë, por mbeti një figurë qendrore politike për shkak të kontrollit të tij mbi PDK-në. Në fillim të vitit 2017, Veseli filloi atë që u quajt si “fushatë dëgjimi”, gjatë së cilës ai zhvilloi një turne nëpër qytete dhe fshatra në Kosovë, duke takuar qytetarët dhe duke ngritur shqetësime mbi drejtimin e vendit dhe punën e qeverisë. Me mbulimin medial nga transmetuesi publik i kontrolluar nga shteti dhe një performancë sipas skenareve të parapërgatitura, vëzhguesit e mprehtë vunë në dukje se turi i Veselit, më shumë se një kontaktim me zgjedhësit, dukej si fushatë personale reklamimi. Ky dyshim u vërtetua të jetë i saktë kur në maj, Veseli paraqiti një mocion mosbesimi ndaj qeverisë në Kuvend. Duke u përballur me një situatë të ngjashme me atë që AKR u përball në vitin 2011, Mustafa dhe LDK mund të bënin pak për të ndaluar lëvizjen e PDK-

9 Kushtet që kanë çuar në formimin e koalicionit PDK-LDK në vitin 2014 tregohen me hollësi në seksionin e mëposhtëm.

së për të braktisur partnerin e saj qeverisë. Mocioni kaloi me mbështetjen e të gjitha partive të opozitës, si dhe të deputetëve të PDK-së.

Në vitin 2017, pre supozimi i PDK-së se qëndronte në pozita të fuqishme u dëshmuar edhe më pak i saktë se në vitin 2014. Është e vështirë të dihen motivet e sakta që çuan Veselin drejt përfundimit të koalicionit me Mustafën dhe LDK-në plot një vit para përfundimit të mandatit të qeverisë. Ashtu sikurse Thaçi në vitin 2014, Veseli ka gjasa të ketë vendosur se rënia e popullaritetit të qeverisë po e dëmtonte PDK-në dhe se zgjedhjet do ta çonin atë në rrëmbimin e kontrollit të qeverisë nga Mustafa. Në vend se t'i qëndronte kursit, Veseli mund të ketë besuar se braktisja e qeverisë do të bënte që fajësimi popullor për problemet e qeverisë në mënyrë të drejtpërdrejtë do të binte mbi kryeministrin dhe partinë e tij, Mustafën dhe LDK-në, dhe të mbronte partinë e tij nga një elektorat dënues. Por ky veprim taktik nuk ndodhi në mënyrën se si e priste Veseli. Krijimi i një koalicioni të madh të partive “të krahut të luftës” (d.m.th. Partitë udhëheqësit e të cilëve dikur ishin figura drejtuese në UÇK), që krahas AAK-së përfshinin partinë e shkëputur nga PDK-ja, Nisma (e udhëhequr nga ish-komandanti i UÇK-së dhe ish-bashkëpunëtori i Thaçit Fatmir Limaj), erdhi me koston që Veselit të pranonte nominimin nga koalicioni për kryeministër të Haradinajt. Është një shenjë se Veseli dhe PDK kishin kuptuar rënien e mbështetjes së tyre dhe kështu ata shkuan deri te ajo sa t'i akomodojnë ish-rivalët Haradinaj dhe Limaj dhe partitë e tyre përkatëse, si dhe nëntë parti të tjera të vogla në një koalicion që, siç doli, gati rrezikonte largimin e PDK-së nga pushteti. Në fund, basti e çoi Veselin aty ku ai edhe filloi, në pozitën e kryetarit të Kuvendit dhe fuqia e partisë së tij u zvogëlua në masë të madhe. Kostoja shtesë për këtë lëvizje ishte ftohja e plotë i PDK-së nga LDK-ja dhe mbështetësit e saj. Duke e ndjerë se partia nuk kishte pësuar thikë pas shpine vetëm një here, por dy herë nga PDK-ja, një pjesë e konsiderueshme e

udhëheqjes së LDK-së dhe e elektoratit të saj u kundërshtuan me zë të lartë çfarëdo koalicioni të ardhshëm me PDK-në. Mustafa ndjeu veten të tradhtuar personalisht pasi ndjeu se LDK i kishte qëndruar deri në fund marrëveshjes duke ofruar votat që Thaçi kishte nevojë që të hynte në presidencë. Ai gjithashtu ndjeu fuqishëm se qeveria ishte në rrugën e duhur dhe se shumë nga kritikantët ishin, jo realiste, rezultat i zellit të opozitës, veçanërisht i LV-së. Ata në LDK, të cilët kishin paralajmëruar kundër një koalicioni me PDK-në në vitin 2011 dhe e kishin kundërshtuar mbështetjen e partisë për një presidencë të Thaçit, u ndjenë se kishin pasur të drejtë dhe u bënë heronj gjatë natës në radhët e mbështetësve të partisë. Sidoqoftë, kjo lëvizje ia kufizoi opsionet e PDK-së pas zgjedhjeve të vitit 2017. Me LV-në dhe LDK-në, të dyja që deklarorin ndalesë për çfarëdo koalicioni të ardhshëm me PDK-në, partia nuk kishte zgjidhje tjetër përveçse të mbështetej në partitë e vogla më të vogla për të krijuar një bazë të mjaftueshme të mbështetjes për të ruajtur fuqinë e saj.

Ndëshkimi i zyrtarëve ekzistues? Tendencat në paqëndrueshmërinë zgjedhore

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2017 sollën një përmbysje të madhe elektorale, pasi partia parlamentare e dikurshme e tretë më e madhe, LV e opozitës, doli si partia me pjesën më të madhe të votave se çdo parti individualisht (figura 2). Dalja e LV-së nga një grup i vogël opozitar deri të ajo që tejkalonte si PDK-në dhe LDK-në në aspektin e votave popullore dhe të përfaqësimit parlamentar do të ishte parashikuar nga pak njerëz disa vite më parë, kur LV-ja zhvendosi strategjinë e saj nga një lëvizje shoqërore opozitare në një parti duke u futur në garën zgjedhore. E themeluar nga aktivisti me përvojë dhe karizmatik Albin Kurti, nën drejtimin e Visar Ymerit, partia ka bërë përpjekje që të evoluojë nga një lëvizje opozitare drejt një partie moderne social-demokrate e krahut të majtë. Më e

rëndësishmja, LV nuk ka shërbyer kurrë në qeveri, duke ngritur në shkallë të lartë reputacionin e saj si një parti “e pastër”, e cila ka qëllime politike dhe programore për Kosovën, në vend se t’u shërbejë interesave të ngushta ekonomike dhe financiare të liderëve të saj. Disfata e befasishme e LDK-së nga LV-ja në zgjedhjet lokale në Komunën e Prishtinës në vitin 2013 dhe udhëheqja e saj në komunë nën kryetarin e komunës Shpend Ahmeti gjithashtu ka ndihmuar në ndërtimin e kredibilitetit popullor të LV-së si një alternativë qeverisëse. Ndryshimi i tonit dhe i mesazhit nga një lëvizje opozitare në një parti të besueshme të qeverisë u bë simbolikisht e dukshme kur Kurti braktisi veshjen e tij joformale duke veshur komplet dhe kravatë gjatë fushatës së vitit 2017. Që nga viti 2008, pavarësisht zbatimit me sukses të planit të Ahtisaarit, zgjerimit të njohjeve ndërkombëtare të Kosovës, duke bërë hapa të rëndësishëm në ndërtimin e një kuadri institucional në mbështetje të shtetit të pavarur të Kosovës dhe mbajtjes së një ritmi të qëndrueshëm të rritjes ekonomike, periudhat e PDK-së dhe LDK-së në qeveri gjithashtu janë shënuar nga skandalet e korrupsionit, premtime të fryra, dështim të nismave të mëdha të politikave dhe lëvizje të ngadaltë në çështjet ndërkombëtare si zgjerimi i anëtarësimit të Kosovës nëpër organizatat ndërkombëtare, përparimi drejt anëtarësimit në BE dhe veçanërisht marrja e të drejtës për kosovarët që të udhëtojnë pa viza në Evropë.

Këto kanë krijuar mundësinë që LV-ja të ofrojë veten si një alternativë qeverisëse më kompetente dhe e pa korruptuar, ndonëse mban temat nacionaliste në lidhje me luftën e viteve 1998-99, ushtrimin e sovranitetit popullor dhe marrëdhëniet e Kosovës me Serbinë dhe Shqipërinë. Mbështetja në rritje që partia mori në zgjedhjet e vitit 2017 është një shenjë se kjo strategji është shpëguar.




Figura 2. Pjesa e votave të PDK-së, LDK-së dhe LV-së në tri palë zgjedhesh (si %). Pjesa e votave të PDK-së në vitin 2017 e përlogaritur në bazë të numrit të vendeve në parlament që i janë ndarë partisë si pjesë e koalicionit të saj më të madh shumë partiak.

Gatishmëria e dukshme e votuesve të Kosovës për të ndëshkuar ata që janë në pushtet dhe që të dobësojë mbështetjen për partitë tradicionale të Kosovës së pas luftës, mund të interpretohet si shenjë e rritjes së pjekurisë demokratike, por edhe si një periudhë e paqëndrueshmërisë në rritje të sistemit partiak në Kosovë pas një periudhe stabiliteti relativ në vitet 2000. Shkencëtarët politik e përcaktojnë paqëndrueshmërinë zgjedhore si ndryshim në sjelljen e votimit ndërmjet zgjedhjeve. Indeksi Pedersen, i krijuar fillimisht nga Mogens Pedersen në vitin 1979, është një masë e zakonshme që përdoret për të përcaktuar paqëndrueshmërinë neto në një sistem partish dhe mat ndryshimin e përgjithshëm në votim në mes dy zgjedhjeve në të gjitha partitë (Pedersen 1979). Që nga viti 2000, politika e Kosovës është dominuar nga dy partitë kryesore, LDK dhe PDK, që rrjedhin nga ndarjet e viteve 1990 mbi të ashtuquajturat kampet e rezistencës “pasive” dhe të armatosur kundër sundimit serb, të parët që përfaqësohen nga LDK-ja dhe këta të fundit nga PDK-ja si pasardhëse

politike e UÇK-së. Megjithatë, siç tregon indeksi (figura 3), kjo nuk iu ka siguruar gjithmonë palëve një elektorat të qëndrueshëm. Paqëndrueshmëria zgjedhore ka qenë mjaft e lartë, me përjashtim të zgjedhjeve të vitit 2004 dhe 2014. Disa arsye për këtë janë shqyrtuar më poshtë.

Shkaqet që qëndrojnë pas paqëndrueshmërisë zgjedhore kanë qenë unike për transformimet në sistemin politik të Kosovës që nga viti 2000 dhe pas pavarësisë. Hidhërimi më i madh erdhi pas vdekjes së udhëheqësit të LDK-së dhe presidentit të Kosovës Ibrahim Rugova në vitin 2006. Me vdekjen e Rugovës, LDK-ja u fragmentua dhe një parti e shkëputur doli nën udhëheqjen e Nexhat Dacit (Lidhja Demokratike e Dardanisë - LDD). Ndonëse LDD-ja mori një pjesë të votave të LDK-së në zgjedhjet e vitit 2007, LDK-ja ende po e humbte një pjesë të madhe të elektoratit të vet, një pjesë të cilëve e humbi në llogari të konkurrentëve, një pjesë e votuesve humbi e që mund të kishin qenë besnikë ndaj Rugovës, por më pak brengoseshin për partinë. Mes viteve 2004 dhe 2007, pjesa e votave të LDK-së ra me mbi 20 pikë përqindje. Një tjetër befasi atë vit ishte performanca mbresëlënëse e AKR-së, e cila ishte një parti e re me pak histori prapa saj dhe nuk mund të identifikohet me shumëçka tjetër përveç emrit të themeluesit të saj, Pacolli, një emigrant multimilioner kosovaro-zviceran i cili u kthye në Kosovë në vitin 2000 për të nisur karrierën e tij politike. Në vitin 2011, surprizë e papritur ishin rezultatet e LV-së, që gjithashtu debutoi fuqishëm atë vit si një forcë elektorale. Ndonëse zgjedhjet e vitit 2014 në masë të madhe e rikonfirmuan konfigurimin e vitit 2011, ato sollën gjithashtu periudhën e rënies së PDK-së. Kjo rënie ishte më dramatike në vitin 2017, ku PDK dhe LDK humbën pjesë të konsiderueshme të votave, dhe LV-ja gati e dyfishoi pjesën e votave të saj.




Figura 3. Paqëndrueshmëria zgjedhore në Kosovë e matur nga indeksi Pedersen.

Shikuar krahasimisht, sipas standardeve të demokracive evropiane, indeksi Pedersen për Kosovën nuk është i pazakontë. Ndërsa paqëndrueshmëria në 2007, 2011 dhe 2014 është më e lartë se mesatarja e Evropës Perëndimore për 10.57, është nën mesataren evropiane të Evropës Qendrore dhe Lindore për 28.32¹⁰. Në të njëjtën kohë, siç thonë analistët, demokracitë e reja në veçanti, zakonisht përballen me nivele të larta të paqëndrueshmërisë. Sistemet partiake priren të jenë më pak të qëndrueshme dhe elektoratet më të hapura për të eksperimentuar me parti të ndryshme (Kitschelt et al., 1999). Shikuar në këto kushte, ndryshimet dramatike në strukturën e partive në Kosovë nuk janë atipike dhe mund të jenë në fakt një shenjë e një zhvillimi të fuqishëm demokratik.

10 Mesataret rajonale evropiane përfitojnë nga Svante Ersson, "Paqëndrueshmëria zgjedhore në Evropë: Vlerësimet dhe shpjegimet e mundshme për dallimet e përafërta," punim i paraqitur në Konferencën e vitit 2012 për Zgjedhjet, Opinionin Publik dhe Partitë (ZOPP), Universiteti i Oxford-it, shtator 2012.

As qeveritë jetë-shkurtra, e as një peizazh partiak që po ndryshon me shpejtësi nuk paraqesin kërcënime për konsolidimin demokratik të Kosovës. Ne e pamë më lart se, duke marrë parasysh mesataret evropiane, qeveritë e Kosovës nuk duket se janë fare shumë jetëshkurtra. Në të njëjtën kohë, ndërsa peizazhi partiak po i nënshtrohet një ndryshimi të konsiderueshëm, zhvillimet atje në të vërtetë mund të jenë të shëndetshme për zhvillimin demokratik të Kosovës. Veçanërisht, gatishmëria e shprehur e elektoratit për t'i hequr ata që janë në pushtet (edhe nëse ata mbeten në pushtet) sugjeron një rritje të pjekurisë së qytetarëve, si dhe të sistemit partiak. Partitë janë gjithnjë e më konkurruese për votuesit dhe kërkojnë ta zgjerojnë bazën e tyre elektorale, që kërkon zgjerimin e mesazhit të tyre, gatishmërinë për të akomoduar ndryshimet brenda partisë dhe hapjen ndaj negociatave dhe kompromisit me aktorë të tjerë politik në interes të qeverisjes dhe për hir të ndjekjes së interesave më të gjera të vendit. Shikuar nga kjo dritë, shqetësimet e dukshme se çështjet kohëzgjatjes së qeverisë dhe paqëndrueshmëria e sistemit partiak duket se janë të pavend, pasi që ato janë thënë në mënyrë relative janë karakteristika normale të zhvillimit demokratik.




Figura 4. Fitoret dhe humbjet nga partitë e përzgjedhura në krahasim me zgjedhjet e mëparshme.

Nga ana tjetër, kriza institucionale në formimin e qeverisë është bërë ajo që duket të jetë një tipar i rëndomtë i politikës kosovare. Të dy zgjedhjet, ato të vitit 2014 dhe ato të vitit 2017 çuan në bllokadat politike në formimin e qeverisë, me periudha të gjata kohore që kalonin nga zgjedhjet për formimin e një qeverie të re. Siç do të tregojë diskutimi i mëposhtëm, në të dyja rastet shkaqet e këtyre ishin politike. Në vitin 2014, një sfidë kushtetuese i lejoi PDK-së që të bllokonte formimin e një qeverie të drejtuar nga opozita. Mekanizmat e njëjtë të krijuara nga aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese në vitin 2014 bënë të mundur që PDK dhe aleatët e saj të përdorin rregulla procedurale për të bllokuar përsëri formimin e një qeverie alternative. Në vazhdim diskutimi tregon ngjarjet që çuan në krizën e vitit 2014 dhe pastaj sërish në krizën e vitit 2017.

Krizat institucionale dhe origjina e tyre politike

Paraliza të cilës iu nënshtrua politika kosovare si në vitin 2014 ashtu edhe në vitin 2017 duket si kërcënimi më serioz për konsolidimin demokratik të Kosovës sesa kohëzgjatja e qeverisë ose paqëndrueshmëria zgjedhore. Problemi në fjalë në këto raste për formimin e qeverive – duket të jenë d.m.th. politikat e pazareve dhe e negociatave që çojnë në koalicione qeverisëse të shumicës. Në vitin 2014, u deshën gjashtë muaj pas zgjedhjeve për të prodhuar një qeveri të re. I njëjti model u përsërit në vitin 2017, kur Kosova kaloi tre muaj pa një qeveri dhe në një gjendje të paralizës së plotë politike.

Përsëri, është e dobishme të fillohet nga një perspektivë krahasuese. Ndryshe nga kohëzgjatja e qeverive në pushtet, kohëzgjatja e *formimit* të qeverive në politikat demokratike ka marrë më pak vëmendje nga shkencëtarët politikë. Ndër ata që i kanë studiuar këto çështje, Ecker dhe Meyer (2015) duhet të shikohen sistematikisht dhe krahasimisht përcaktuesit e proceseve të formimit të qeverive në Evropë. Ata janë veçanërisht të interesuar që të zbulojnë atë që shpjegon modelet se pse procesi i negociimit të një qeverie të re kërkon periudha jashtëzakonisht të gjata kohore. Për ta bërë këtë, Ecker dhe Meyer statistikisht shqyrtojnë 297 procese të formimit të qeverive në 27 demokraci evropiane.

Analizat e Ecker dhe Meyer tregojnë se proceset e *formimit* të qeverisë kishin marrë mesatarisht 28 ditë në Evropën Perëndimore dhe 29 ditë në Evropën Qendrore dhe atë Lindore. Të dhënat e tyre tregojnë se proceset e formimit të qeverisë kanë marrë mesatarisht më së shumti kohë në Holandë (90 ditë), Austri (75 ditë) dhe Itali (42 ditë), me pikën më të gjatë të të dhënave për më shumë se 220 ditë (në Holandë)¹¹. Në Evropën Qendrore dhe Lindore,

11 Në të dhënat e Ecker dhe Meyer nuk përfshihet rasti i qeverisë Di Rupo në

mesatarja më e gjatë e kohës mbahet nga Republika Çeke (39 ditë). Megjithatë, mesataret e përgjithshme tregojnë se nuk ka dallim të konsiderueshëm midis Evropës Perëndimore dhe Evropës Qendrore dhe asaj Lindore në këtë drejtim. Ecker dhe Meyer më tej i kategorizojnë të dhënat e tyre në dy dimensione (të paraqitura në figurën 5): konteksti në të cilin u zhvillua procesi i formimit të qeverisë dhe sa kompleks ishte procesi i negociatave. E para bën dallim ndërmjet formimit të qeverisë ndërmjet dhe pas zgjedhjeve (brenda kohës së zgjedhjeve dhe pas zgjedhjeve). Komplexiteti i pazareve/negotiatave shprehet nga numri i palëve të mundshme që përfshihen në negociata, duke supozuar që sa më shumë parti që të përfshihen aq më shumë pretendime mbi qëllimet dhe politikat do të ketë për të shqyrtuar dhe akomoduar në koalicion dhe për këtë arsye krijohet një kompleksitet më i madh në bisedime (dhe si rrjedhojë mund të zgjasin më shumë). Në këtë drejtim dalin disa dallime rajonale, me mesataret që janë më të larta për proceset e formimit të qeverisë pas zgjedhjeve në Evropën Qendrore dhe Lindore (43 ditë) krahasuar me Evropën Perëndimore (18 ditë).

Ndonëse përfaqësojnë trendet mesatare, këta numra japin një pikë të dobishme krahasimi me procesin e formimit të qeverisë në Kosovë. U deshën 72 ditë që partitë e Kosovës të formojnë një qeveri pas zgjedhjeve të vitit 2010. Në këtë rast, një pjesë e vonesës ishte shkaktuar nga akuzat e shumta dhe serioze të mashtrimit zgjedhor, që gjeneruan një numër rinumërimesh dhe e zgjatën procesin e certifikimit të rezultateve, gjë që në çdo rast është i ngadaltë në Kosovë. Bisedimet midis partisë dominuese, PDK-së dhe partisë së re të AKR-së, që kishte hyrë në parlament për një koalicion, ishin relativisht të shpejta. Për dallim nga kjo, në vitin 2014 Kosova ka kaluar 184 ditë pa një qeveri të re dhe

Belgjikë të formuar në vitin 2011, të cilës iu deshën 589 ditë për tu formuar, më e gjata në historinë e ndonjë vendi demokratik.

sërish 90 ditë pa një qeveri të re në vitin 2017. Krahasuar me mesataret evropiane, këto janë periudha tepër të gjata dhe e vendosin Kosovën në rangun e vendeve me periudha të gjata të proceseve të formimit të qeverisë.




Figura 5. Ndarja e kohëzgjatjes së pazareve/negotiatave bazuar në pasigurinë dhe kompleksitetin në Evropë. Burimi: Ecker dhe Meyer (2015).

Pasi që ata janë të interesuar për përcaktuesit qendrorë të kohëzgjatjes së proceseve të formimit të qeverive brenda një shumëllojshmërie të gjerë të rasteve, Ecker dhe Meyer përqendrohen në paqartësinë e pazareve/negotimit dhe në kompleksitet, të cilin ata e teorizojnë si shumë të rëndësishëm në shpjegimin se pse disa qeveri kanë më shumë kohë për t'u formuar. Ata konstatojnë se pasiguria e krijuar pas zgjedhjeve është e favorshme për periudha më të gjata bisedimesh. Për Evropën Perëndimore, ata konstatojnë se një numër më i madh i partive parlamentare gjithashtu e shton kohëzgjatjen e proceseve të formimit të qeverive (edhe pse nuk gjejnë efekte të ngjashme në Evropën Qendrore dhe Lindore). Për Evropën Perëndimore ata gjithashtu zbulojnë

se efektet e kombinuara të pasigurisë, kompleksitetit dhe polarizimit partiak janë përcaktues të fortë të periudhave më të gjata të formimit të qeverisë. Konstatimet e tyre për Evropën Qendrore dhe Lindore janë më pak bindëse.

Në rastin e Kosovës, pa dyshim, pasiguria dhe marrëdhëniet e reja të forcës politike të krijuar pas zgjedhjeve krijojnë një mjedis të favorshëm për periudha të zgjatura të pazareve/negotiatave. Megjithatë, deri më tani, Kosova nuk ka përjetuar një situatë ku një qeveri e re koalicioni të jetë formuar ndërmjet zgjedhjeve, pasi që çdo rënie e qeverisë është shoqëruar me thirrjen për zgjedhje të reja. Në të njëjtën kohë, ndonëse kompleksiteti pa dyshim është faktor në procesin e pazareve/negotiatave, në shumicën e rasteve ka qenë besnikëria e një partie (të madhe apo të vogël) në një koalicion në pritje që zakonisht e ka bërë dallimin në formimin e qeverisë. Në vitin 2007 dhe vitin 2014, LDK-ja vendosi të bashkohej me PDK-në në qeveri; në vitin 2010 dhe 2017 ishte AKR-ja që iu bashkua PDK-së ose (në vitin 2017) koalicioni i dominuar nga PDK-ja që çoi në formimin e një qeverie. Në Kosovë, një faktor tjetër i ndërlikuar në formimin e qeverisë është kushti kushtetues për të përfshirë në qeveri e partitë që përfaqësojnë pakicat etnike (jo-shqiptare). Ndonëse këto kryesisht janë parti shumë të vogla që përfshihen në qeveri pa vështirësi të mëdha, roli i tyre mund të bëhet i rëndësishëm, sa më e fragmentuar të jetë ndarja e votave ndërmjet partive më të mëdha. Në vitin 2017, mbështetja për partinë Lista Serbe dhe deputetët e saj ishin vendimtare për sa i përket aftësisë së Ramush Haradinaj për të formuar qeverinë e tij. Megjithatë, siç u tha, në të dyja vitet 2014 dhe 2017, partia dhe/ose koalicioni dominues mund të zgjasë periudhën e formimit të qeverisë (d.m.th., pengojë formimin e një koalicioni alternativ) përmes instrumenteve procedurale. Ekzistojnë dy gjëra që duhet të merren parasysh: së pari, nga çfarë përbëhet kjo veçori procedurale dhe si është shfaqur ajo; dhe së dyti, pse, pavarësisht vështirësive procedurale, formimi i qeverive të

reja bëhet politikisht gjithnjë e më i vështirë. Të dyja këto kërkojnë që ne përsëri të kthehemi në rastet studimore të zgjedhjeve 2014 dhe 2017 dhe në atë që pasoi më pas.

Zgjedhjet e vitit 2014

Me Zgjedhjet e vitit 2014 u nisë praktika e bllokadave kushtetuese që i mbajnë peng proceset e formimit të qeverisë sipas vullnetit të partisë dominuese. Ndonëse pjesa e votave të PDK-së nuk u zvogëlua në mënyrë dramatike që nga zgjedhjet e mëparshme, asnjë parti opozitare nuk ishte e gatshme të bashkohej me PDK-në në një koalicion pas zgjedhor. Partneri i saj i mëparshëm AKR u largua nga parlamenti, ndërsa pjesa e saj e votës ra poshtë pragut zgjedhor. Një numër i figurave kryesore të PDK-së, duke përfshirë Fatmir Limajn dhe ish-kryetarin e Kuvendit Jakup Krasniqin u shkëputën nga partia për të formuar Nisma-n, gjersa drejtonin akuza të rënda ndaj lidhshimit të PDK-së së Thaçit. Nisma hyri në parlament si një grup i vogël parlamentar. Në të njëjtën kohë, përqindja e votave në LV-së u rrit mjaftueshëm për të treguar se aktiviteti i saj opozitar ishte efektiv në mobilizimin e votave. LV-ja ishte veçanërisht e vendosur të refuzonte hyrjen në ndonjë koalicion që përfshinte PDK-në. Në të njëjtën kohë, LDK dhe AAK rifilluan aleancën e tyre të vjetër, dhe në qershor të vitit 2014 nënshkruan një marrëveshje koalicioni së bashku me Nisma-n¹². Sipas marrëveshjes, LDK-ja dhe Nisma do t'i bashkoheshin një qeverie nën Haradinajn e AAK-së si kryeministër. Në këmbim të kësaj, LDK-ja do të kontrollojë kryesimin e Kuvendit dhe do të emëronte një President të ri pas përfundimit të mandatit të Atifete Jahjagës në vitin 2016.

Të ndier të izoluar, Thaçi dhe PDK nuk mund të bënin

12 “Ekskluzive: Ja marrëveshja e AAK-LDK-NISMA,” Zëri, 10 qershor 2014. Gjendet në: <http://old.zeri.info/artikulli/37399/ekskluzive-ja-marreveshja-e-aak-ldk-nisma-fotodokument> (për herë të fundit e qasur më 15 nëntor 2017).

shumë, por kërkonin arsye juridike se pse nuk mund të formohej asnjë qeveri pa ta. Seanca konstituive e Kuvendit të ri të Kosovës më 17 korrik 2014, ua dha rastin. Seanca e parë konstitutive e pas zgjedhjeve përfshin verifikimin e mandatit të deputetëve të rinj, betimin në ceremoni dhe zgjedhjen e një udhëheqjeje të re të Kuvendit (të kryetarit dhe zëvendës kryetarëve). Hapi i fundit në veçanti është kyç në lejimin e Kuvendit që të vazhdonte me punën e tij sipas rregullave kushtetuese, duke përfshirë zgjedhjen e një qeverie të re. Gjatë seancës, sipas procedurës normale, grupi parlamentar i PDK-së nominoi për kryetar të Kuvendit dikë nga radhët e tyre. Megjithatë, deputetët nga LDK, AAK dhe Nisma (koalicioni LAN), së bashku me ata të LV-së, u larguan nga salla e Kuvendit, duke e lënë kandidatin e PDK-së pa vota të mjaftueshme për t'u zgjedhur. Kryesuesi ceremonial i seancës konstituive - i cili sipas Kushtetutës është deputeti më i vjetër në Kuvend (dhe në këtë rast ka ndodhur të jetë një deputete e PDK-së) - më pas deklaroi se mbledhja kishte përfunduar. Duke e injoruar thirrjen e kryesuesit për të shtyrë takimin, opozita ishte kthyer në sallën e Kuvendit dhe kishte vazhduar takimin e vet pa praninë e deputetëve të PDK-së. Me deputetin e dytë më të vjetër që tani ishte përgjegjës për procedimet, deputetët e opozitës e votuan Isa Mustafën e LDK-së si kryetar të Kuvendit. Në fakt, koalicioni LAN, me mbështetjen e LV-së, vazhdoi të zbatonte marrëveshjen e tyre dhe të bënte hapin e parë drejt formimit të një qeverie të udhëhequr nga LAN-i. Me 63 deputetë, LAN dhe LV kishin një shumicë të mjaftueshme parlamentare për të formuar qeverinë pa PDK-në.

Duke akuzuar LAN-in, LV-në dhe deputetët e tjerë se kishin zgjedhur një kryetar në mënyrë të parregullt, PDK bëri lëvizjen që të ngriste çështjen e zgjedhjes së kryetarit në Gjykatën Kushtetuese. E bëri këtë duke paraqitur një ankesë ditën tjetër. Gjykata menjëherë e “pezulloi” zgjedhjen e Mustafës në kryesimin e Kuvendit, duke e bllokuar në

mënyrë efektive çdo punë tjetër të Kuvendit të ri. Më 26 gusht, Gjykata nxori aktvendimin e saj përfundimtar ku përcaktonte se zgjedhja e Mustafës në kryesimin e Kuvendit ishte e parregullt dhe si rrjedhojë e pavlefshme. Në aktvendim deklarohet se parregullsitë kishin rrjedhur nga mungesa e kuorumit të pranishëm në mbledhjen e Kuvendit, se nominimi i kryetarit nuk ishte bërë nga grupi më i madh parlamentar dhe se Kuvendi duhet ta përsëriste mbledhjen e vet konstituive sipas procedurave të përcaktuara në Kushtetutë¹³. Në aktvendim gjithashtu bëheshin një numër interpretimesh rigoroze të kushtetutës që ishin të rëndësishme si për krijimin e qeverisë në vitin 2014 dhe u spikatën sërish në vitin 2017. Për shkak të rëndësisë së tyre, këto gjëra janë përshkruar në disa detaje më poshtë.

Një element kyç i aktvendimit përfshinte leximin e Kapitullit IV, neni 67, të Kushtetutës së Kosovës. Në atë nen përcaktohen procedurat për themelimin e Kuvendit pas zgjedhjeve të përgjithshme dhe zgjedhjes së udhëheqjes së tij. Duke specifikuar se Kuvendi zgjedh një kryetar dhe pesë nënkryetarë, më problematike ishte pika 2 e nenit 67 ku thuhet: “Kryetari i Kuvendit propozohet nga grupi më i madh parlamentar dhe zgjidhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit”¹⁴. Në aktvendimin e saj, Gjykata vendosi se në këtë rast, “grupi më i madh parlamentar” do të thoshte partia me numrin më të madh të deputetëve (pavarësisht asaj nëse partia kontrollon një shumicë absolute). Gjykata vendosi se në përcaktimin e “grupit më të madh parlamentar”, përparësi iu dha rezultateve të zgjedhjeve dhe ndarjes së vendeve në Kuvend. Si rrjedhojë “Grupi më i madh parlamentar” thjesht nënkuptonte partinë ose koalicionin me më së shumti vende

13 Gjykata Kushtetuese e Kosovës, Aktgjykimi në Rastin Nr. KO119/14 (versioni në anglisht) (Prishtinë, Kosovë), 26 korrik 2014.

14 Republika e Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës (versioni në anglisht).

në Kuvend. Duke cituar nga ai aktvendim.

Kushtetuta në nenin 64 (1) parashikon që kur të strukturohen Kuvendet, vendet duhet të ndahen në përpjesëtim me numrin e votave të fituara në zgjedhjet për Kuvend. Ndarja e vendeve bëhet midis partive, koalicioneve, iniciativave qytetare dhe kandidatëve të pavarur në përpjesëtim me rezultatet e arritura në zgjedhjet parlamentare. Kjo do të thotë që partive, koalicioneve, iniciativave qytetare dhe kandidatëve të pavarur u jepet numri i vendeve, që janë të barabarta me mandatet e deputetëve, që korrespondojnë proporcionalisht me votat që ata kanë marrë në zgjedhje, me kusht që këto parti, koalicione, iniciativa qytetare dhe kandidatë të pavarur të kenë kalua pragun. *Kushtetuta u jep përparësi rezultateve të zgjedhjeve si kriter*¹⁵.

Për më tepër, Gjykata e përsëriti qëndrimin që kishte marrë në një aktvendim paraprak mbi kuptimin e “koalicionit”. Ky aktvendim u nxor në përgjigje të një kërkesë të dërguar nga Presidentja Jahjaga mbi procedurën e duhur për përcaktimin e fituesit në një sërë zgjedhjesh duke pasur parasysh mungesën e qartësisë mbi këtë çështje në Kushtetutë¹⁶. Në atë rast, Gjykata vendosi që një “koalicion” definohej si një koalicion *parazgjedhor*, që të ishte i regjistruar si i tillë në përputhje me ligjin e zgjedhjeve në Kosovë (dhe kështu garonte në zgjedhje si koalicion i regjistruar). Një koalicion pas-zgjedhor i formuar nga partitë pas zgjedhjeve nuk i plotësonte kushtet kushtetuese për t’u llogaritur si “grupi më i madh parlamentar” dhe për këtë arsye nuk e gëzonte të drejtën e nominimit të kryetarit të Kuvendit. Aktvendimi vendosi një pengesë serioze

15 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykimi në Rastin Nr. KO119/14 (versioni në anglisht) (Prishtinë, Kosovë), 26 korrik 2014, f. 40. Shtohet theksi.

16 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykimi në Rastin Nr. KO103/14 (versioni në anglisht) (Prishtinë, Kosovë), 1 korrik 2014.

procedurale në përpjekjet e koalicionit LAN për formim të qeverisë dhe e bëri procesin e bëri procesin e konstituimit të Kuvendit të ri të Kosovës tërësisht të varur nga vullneti i PDK-së për të propozuar një kryetar të Kuvendit.

Pas aktvendimit të Gjykatës në muajin gusht, Kosova kaloi gjashtë muaj në bllokadë të plotë politike, me PDK-në që nuk donte të thërriste një mbledhje të Kuvendit dhe VLAN-in (koalicioni i zgjeruar të cilit LV-ja iu bashkua në shtator)¹⁷ që refuzonte të votonte për kandidatin e PDK-së ose të formonte një qeveri me atë parti. Përfundimisht, në dhjetor, Mustafa dhe LDK papritmas i thyen lidhjet e tyre me VLAN-in dhe nënshkruan një marrëveshje të re koalicioni me Thaçin dhe PDK-në. Ndonëse marrëveshja parashihte që Thaçi të hiqte dorë nga pozita e tij si kryeministër në favor të Mustafës, ajo përfshinte dhënien e kontrollit të Kuvendit dhe të Presidencës, PDK-së. Në prill të vitit 2016, Kuvendi e zgjodhi Thaçin president, ku LDK-ja dha votat e saj vendimtare.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese i vitit 2014 dhe zgjedhjet e vitit 2017

Vendimi i Gjykatës në vitin 2014 ishte kryesori në dinamikën që u zhvillua pas zgjedhjeve të vitit 2017. Ndonëse grumbulloi më së shumti vota, koalicioni i udhëhequr nga PDK-ja me AAK-në, Nisma-n dhe nëntë parti të tjera të vogla (koalicioni i ashtuquajtur PAN) kishte një numër të pamjaftueshëm deputetësh në Kuvendin e ri për të formuar i vetëm qeverinë. LDK-ja, duke u ndjerë e goditur pas shpine pas vendimit të PDK-së për të hequr mbështetjen e saj për qeverinë e koalicionit, refuzoi të bashkohej me PAN-in në një koalicion të ri nën Haradinajn. Natyrisht LV-ja nuk ishte e prirë për t'u bashkuar me ndonjë

17 “Nënshkruhet Marrëveshja LAN – Vetëvendosje,” Koha Net, 10 shtator 2014. Gjetend në <http://archive.koha.net/?idw27&lw24920> (për herë të fundit e parë më 15 nëntor 2017).

koalicion me PDK-në. Ky polarizim i thelluar rezultoi me një bllokim të ri politik.

Pak kohë pas zgjedhjeve, kishte shenja se po punohej për një koalicion LV- LDK. Ndonëse asnjë marrëveshje nuk ishte lidhur ndonjëherë ndërmjet LV-së dhe LDK-së, të dyja partitë kontrollonin bashkërisht një shumicë komode në Kuvendin e ri që do t'u lejonte atyre të krijonin qeverinë. Megjithatë, duke u mbështetur në nenin 67(2) dhe në interpretimin e Gjykatës të vendimin të saj të vitit 2014, PAN-i mund të mbante peng konstituimin e Kuvendit të ri pambarimisht. PAN-i e bëri këtë thjesht duke refuzuar të nominonte një dikë për kryetar të Kuvendit, gjë që kishte të drejtë ta bënte në përputhje me këtë rregull si grupi më i madh parlamentar (sipas formulimit të Kushtetutës dhe interpretimit të Gjykatës). Në thelb, PAN-i e mbajti peng formimin e Kuvendit të ri dhe të qeverisë derisa njëra nga partitë e tjera të vendoste të bashkohej me të në një koalicion. Situata vazhdoi edhe për tre muaj të tjerë, me palët që refuzonin të lëvizin nga pozicionet e tyre, dhe PAN-in që refuzonte të nominonte dikë për kryetar të Kuvendit. Situata u zgjidh përfundimisht kur AKR, pjesë e koalicionit të madh të LDK-së, u nda nga ky koalicion dhe iu bashkua PAN-it për t'i dhënë qeverisë së re Haradinaj një shumicë të vogël prej 61 vendesh në Kuvend.

Ndonëse vendimi i Gjykatës i vitit 2014 qëndron në një lexim rigoroz dhe të fjalëpërfjalshëm të ligjit, shfrytëzimi i mekanizmave procedural për të prodhuar një bllokim politik që do t'i shërbente qëllimit të rritjes së pozicionit negociues të partisë mbi formimin e koalicioneve post-zgjedhore nxjerr në pah thellësisht problematikën e natyrës së sistemit që është vënë në vend. Rregullat kushtetuese dhe ligjore gati gjithmonë përmbajnë zbrazëtira dhe paqartësi që kanë të bëjnë me veçoritë e një situatë të caktuar, të cilat në demokracitë e konsoliduara trajtohen nga aktorë të ndjekur nga normat e nënkuptuara që në përgjithësi janë respektuar

nga të gjithë aktorët politikë. Shembulli i rëndomtë i kësaj është funksionimi i sistemit gjysmë-presidencial francez, i ashtuquajturi sistem ko-habitacioni. Megjithatë, Kushtetuta franceze nuk e mandaton atë, Presidenti zakonisht merr një pozicion paksa më zbrapsur ndaj kryeministrit kur zgjedhjet parlamentare fitohen nga opozita dhe ata e marrin kontrollin e qeverisë. Në teori Presidenti gëzon autoritet të mjaftueshëm kushtetues për të bllokuar të gjitha nismat e qeverisë, por në praktikë presidentët francezë përkulën ndaj sundimit të shumicës (parlamentare) dhe marrin funksione më ceremoniale. Në sistemet e tjera parlamentare rregullat e formimit të qeverisë gjatë transicionit të pushtetit përfshijnë një sërë rregullash të pashkruara. Në disa shtete kreu i shtetit emëron një *ndërmjetës*, në mënyrë tipike një zyrtar apo politikan të lartë, ose në pension, në krye të procesit të identifikimit dhe të negociimit të një koalicioni. *ndërmjetësi* nuk e udhëheq qeverinë e re (diçka që bie mbi formuesin, të emëruar pasi *ndërmjetësi* ka arritur me sukses të arrijen e një marrëveshje koalicioni) dhe nganjëherë ai/ajo nuk bëhet fare anëtar i kabinetit. Norma të tilla joformale që e rregullojnë procesin e transferimit të pushtetit e që respektohen nga akterët politikë ndihmojnë në ndërtimin e drejtpërdrejtë të koalicionit dhe në formimin e qeverisë në rastet kur rregullat kushtetuese janë shumë të ngurta ose kur zbatimi i tyre i drejtpërdrejtë është i pakuptimtë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme të madhe në sistemet parlamentare ku nuk dominon asnjë parti si e vetme dhe ku koalicionet negociuese janë një proces politikisht i ndjeshëm dhe vendimtar që e mundëson vullnetin e elektoratit të shprehur në preferenca thjesht sasiore për t'u përkthyer në qeverisje domethënëse nga shumica parlamentare.¹⁸

Partitë në Kosovë kanë dëshmuar se ende nuk kanë zhvilluar norma të tilla joformale, të paktën jo ato që ndahen nga të

¹⁸ Rregulla e shumicës këtu definohet thjesht si partia ose koalicioni që kontrollon së paku 50% + 1 të votave në Parlament.

gjitha palët, që lejojnë kalimin e pushtetit pa krijuar krizë politike. Kreu i shtetit po ashtu luan një rol të rëndësishëm gjatë këtyre periudhave të transicionit. Në vitin 2014, kur Presidentja Jahjaga iu drejtua Gjykatës Kushtetuese sugjeronte se zyra e saj ishte e pasigurt se si të procedohej në situatën e një bllokade politike, duke pasur parasysh përvojën e kufizuar demokratike të Kosovës. Duke vepruar kështu, Jahjaga u tregua e gatshme të angazhohej dhe të jepte një shembull se si roli i Presidentit si kreu i shtetit po i bashkonte palët për të negociuar një marrëveshje koalicioni dhe për të mbikëqyrur një transicion paqësor të pushtetit. Në vitin 2014, Presidentja Jahjaga organizoi një numër tryezash të rrumbullakëta me të gjitha partitë e pranishme. Por takime e tilla ishin ushtrime të pakuptimta të marrëdhënieve me publikun, duke pasur parasysh se paqartësia dhe pasiguria lidheshin me krijimin e një qeverie që përjashtonte partinë më të madhe parlamentare, diçka që është një praktikë normale në shumicën e demokracive parlamentare, por e re për sistemin politik të Kosovës. Në vitin 2017, me Thaçin në presidencë, LV-ja dhe LDK-ja nuk kishin besim në këtë institucion që të shërbente si ndërmjetësues i procesit dhe kreu i shtetit publikisht dukej edhe më larg nga zhvillimet politike pas zgjedhjeve. Mënyra alternative për organizimin e normave të tilla joformale ekziston edhe në teori. Për shembull, partitë politike mund ta ndanin procesin e zgjedhjes së udhëheqjes së Kuvendit nga procesi i formimit të qeverisë, duke ia lejuar udhëheqjen ceremoniale të Kuvendit, grupit më të madh parlamentar (me zgjedhjen rituale të kryetarit nga radhët e tij, pavarësisht nga rezultatet e zgjedhjeve dhe koalicionit eventual qeverisës). Nga ana tjetër, duke e ditur mungesën e mbështetjes në Kuvend, grupi më i madh parlamentar mund t'ia lëshonte kryetarllëkun grupit të dytë më të madh dhe të mbështeste nominimin e një kryetari nga radhët e tij, ose të

vendosnin një figurë të lartë politike, pavarësisht nga germat e ligjit.¹⁹ Me fjalë të tjera, nëse respekti për institucionet demokratike dhe tranzicioni i pushtetit do të ishte shqetësimi i tyre kryesor, ka shumëllojshmëri mënyrash që në teori, partitë mund të kishin zhvilluar modele joformale që mund të menaxhonin situata si ato të viteve 2014 dhe 2017 dhe të parandalonin vendin që të rrëshqiste në krizë politike. Por, pasi që kontrollimi i kryesimit të Kuvendit është zakonisht pjesë e pazareve/marrëveshjes politike midis partive që formojnë qeverinë – dhe gjithashtu përmban pushtet të konsiderueshëm, duke pasur parasysh kontrollin e kryetarit mbi agjendën legjislative të Kuvendit - aranzhimet e tilla joformale dukeshin të jenë jashtë kufijve të mundësisë në ambientin e vrazhdë politik të Kosovës.

Si rezultat, dështimi i partive për të krijuar norma të caktuara joformale që e lehtësojnë dhe menaxhojnë procesin e tranzicionit zbuloi se sa absurde dhe tërësisht antidemokratike ishin rregullat ekzistuese. Në thelb, në gjendjen e tanishme, duke ia dhënë “grupit më të madh parlamentar” të drejtën ekskluzive për të nominuar kryetarin e Kuvendit, neni 67 (2) i Kushtetutës i *detyron* deputetët që të votojnë për kandidatin e grupit më të madh parlamentar pavarësisht vullnetit të tyre. Nëse këta deputetë nuk votojnë për kandidatin e grupit më të madh parlamentar, partia më e madhe parlamentare thjesht mund të bllokojë zgjedhjen e udhëheqjes së Kuvendit dhe të paralizojë jetën politike pas-zgjedhore. Kjo është pikërisht ajo që bëri PAN-i pas qershorit të vitit 2017.

E thënë në terma më formalë, dispozita që vetëm grupi më i madh parlamentar ka të drejtë të nominojë një kryetar për Kuvendin është në kundërshtim me të paktën tre parime themelore të qeverisë parlamentare. Së pari, e shkel parimin

19 Teknikisht nuk është e paligjshme që grupi më i madh parlamentar ta nominojë kryesuesin që është nga radhët e veta.

e barazisë së të gjithë deputetëve në të drejtën e fjalës, për nisma legjislative, dhe të drejtën për të nominuar dhe për t'u nominuar. Së dyti, e shkel parimin e lirisë së deputetëve për të votuar sipas ndërgjegjes së tij/saj, duke kërkuar në mënyrë implicite që deputetët e partive të tjera të votojnë për një kandidat që ata nuk e miratojnë, thjesht sepse ai ose ajo është i nominuari i partisë me të drejtën ekskluzive për të nominuar. Dhe e fundit, kjo rregull është në kundërshtim me parimin më themelor parlamentar të sundimit të shumicës. Interpretimi i ngurtë i paraqitur nga Gjykata Kushtetuese ndalon drejtpërdrejt ushtrimin e rregullit të shumicës në Kuvendin e Kosovës për çështjen themelore të zgjedhjes së kryetarit. Praktikrat që janë vendosur që nga viti 2014 ia kanë dhënë në mënyrë efektive fuqinë e shantazhit procedural cilësdo partie apo koalicioni që merr më së shumti vota, si një mjet për të detyruar ardhjen e saj/tij në qeveri.²⁰

Për më tepër, procedura e përcaktuar në Kushtetutën e Kosovës ka pak paralele me vende të tjera demokratike. Në shumicën e vendeve, zgjedhja e kryetarit të Kuvendit është një çështje që përcaktohet nga vetë Rregullorja e Parlamentit, në vend se të përcaktohet në Kushtetutën e vendit. I tillë është rasti në Gjermani, ku nominimi i kryetarit të përbërjes së re të Kuvendit të sapoformuar nuk është i përcaktuar në përputhje me përkatësinë partiake, por

20 Akterët ndërkombëtarë kanë kontribuar në këtë situatë ose me veprime apo mosveprime. Në vitin 2014, kishte raporte se shpërbërja e VLAN-it ishte pjesërisht si rezultat i presioneve nga ambasadat perëndimore, të cilët ishin veçanërisht të shqetësuar për përfshirjen e LV në qeveri, të cilën ata e konsideronin si një organizatë politike radikale (për shkak të metodave të veprimit të drejtpërdrejtë, kritikrat e saj të shpeshta për ndërhyrjen ndërkombëtare në çështjet e Kosovës dhe kundërshtimin e saj ndaj negociatave me Serbinë). Kishte gjithashtu pak presion të drejtpërdrejtë ndaj PDK-së për të hequr dorë nga pushteti pasi u bë e qartë se kjo parti nuk kishte mbështetje të mjaftueshme për të formuar qeverinë. Në vitin 2017 ishte vullneti i akterëve ndërkombëtarë që të mos marrin qëndrim të vendosur mbi nevojën që akterët e Kosovës të zbatojnë dhe të ndjekin normat demokratike dhe të tolerojnë koalicionin PAN që të mbante peng sistemin politik që ndihmoi në legjitimimin e veprimeve të PAN-it

thjesht si cilido kandidat i nominuar që merr shumicën e votave. Kjo ia lehtëson punën partisë apo koalicionit dominues në zgjedhjen e një kryetari, pa pengesa procedurale apo bllokada. Aranzhime të ngjashme ekzistojnë në Shqipëri, Bullgari, Kroaci, Maqedoni, Portugali, Slloveni, dhe Greqi, ndër të tjera, ku zgjedhja e kreut të Parlamentit konsiderohet një çështje e rregulluar me rregullat e brendshme të trupit parlamentar se sa një çështje kushtetuese. Në rastin e Kosovës, këto rregulla me të meta janë bartur nga Korniza Kushtetuese, dokumenti udhëheqës që përdorej, gjersa Kosova ishte ende nën administrimin e UNMIK-ut. Në atë kohë, natyra e të metave të këtyre rregullave mbeti e pa ekspozuar, sepse në të gjitha rastet partia më e madhe gjente një partner të gatshëm për të qeverisur. Ngjashëm, kjo rregull nuk përbënte problem në vitin 2010, kur edhe PDK-ja nuk u përball me asnjë vështirësi në gjetjen e një partneri koalicioni. Kjo ndodh vetëm kur partia më e madhe nuk është në gjendje të tërheq një partner koalicioni (ose partnerë) kur neni 67 (2) ofron instrumente për krijimin e bllokadës politike. Duke pasur parasysh strukturën e fragmentuar të partive në Kosovë, pritet që situata të tilla të përsëriten në të ardhmen, pavarësisht nëse partia me kontrollin mbi shumicën është PDK-ja ose ndonjë parti tjetër.

Përveç kostove ekonomike të bllokadave politike dhe kohës së humbur në grindjet politike që e marrin kohën dhe energjinë nga nismat legjislative dhe të politikave që janë të nevojshme në një vend të ri dhe me ekonomi të dobët siç është Kosova, mekanizmi kushtetues që parashihet nga neni 67 (2) gjithashtu rrezikon deligjimitimin e vetë qeverisjes demokratike. Kuptuar më thjesht si qeverisje e shumicës, kjo rregull e pengon negocimin e lirë të marrëveshjeve politike mes partive konkurruese pas zgjedhjeve në krijimin e koalicioneve qeverisëse, dhe i jep partisë ose koalicionit që ka ndodhur që të marrë më së shumti vota fuqi të panevojshme, për t'u imponuar në ndonjë negociatë. Kjo

rregull tashmë i ka krijuar pritjet (e paarsyeshme, sipas standardeve dhe praktikës demokratike) se partia me më së shumti vota *gjithmonë* hyn në qeveri. Kjo pritje, siç kanë treguar rastet e PDK-së dhe PAN-it, mund të kontribuojë në thellimin e polarizimit politik, në koalicionet e “panatyrshme” ndërmjet liderëve dhe partive që në sytë e shumë votuesve duken të gatshëm të pranojnë çdo marrëveshje dhe të negociojnë me këdo - përfshirë edhe një ish-armik politik - që do t’i merrte ata në pushtet, dhe në qeverisje të dobët dhe joefektive.

Paqartësitë dhe kompleksiteti në procesin e formimit të qeverisë së Kosovës

Duke iu kthyer analizës së Ecker dhe Meyer rreth proceseve të formimit të qeverisë në Evropë, shohim se pasiguria dhe kompleksiteti dalin në mënyra shumë të ndryshme në Kosovë, kur të merret një qasje më kontesktuale dhe e bazuar në rast për krizat e vitit 2014 dhe 2017. Pasiguria pas-zgjedhore në kontekstin e demokracisë së Kosovës përfshin jo vetëm marrëdhëniet e reja të forcës politike të dalë nga zgjedhjet, por edhe pasigurinë mbi rregullat e procedurës. Në vitin 2014, kjo pasiguri ishte më e thellë dhe më serioze se në vitin 2017, kur vendimi i Gjykatës Kushtetuese i kishte sqaruar rregullat (e diskutueshme dhe anuese) në vend. Megjithatë, në vitin 2017 akterët politikë ishin të pasigurtë se si të procedohet nëse PAN-i do të nominonte dikë për kryetar të Kuvendit, dhe kandidati nuk do të arrinte të merrte votat e mjaftueshme. A do të vazhdonte PAN-i të nominonte individë, deri sa të mos mbetej asnjë pa u nonimuar? A do të ulej në fund të fundit të negociante me LV-në dhe LDK-në transferimin e pushtetit? Apo me ndonjë procedurë të pacaktuar, opozita disi do ta merrnin të drejtën për të bërë nominimin e tyre? Apo thjesht a do ta shpërndante Kuvendi veten dhe të caktonte zgjedhje të reja? Këto paqartësi pa dyshim i bënë negociatat alternative midis LV-së dhe LDK-së më të

vështira, pasi nuk ishte e qartë nëse këto negociata, edhe në qoftë se do të ishin të suksesshme, a do të ishin kuptimplota. Në të njëjtën kohë, duke pasur parasysh armiqësitë mes partive që ishin krijuar gjatë periudhës së qeverisë Mustafa (kritikave pa filtër të politikave të saj dhe kundërshtimet veçanërisht të forta për çështjen e demarkacionit të kufirit me Malin e Zi), identifikimin e tyre me kampe ideologjike kundërshtare (me LV-në të identifikuar si e qendrës së majtë, dhe LDK-në si parti e qendrës së djathtë), të dyja palët rrezikonin ta komprometonin një pjesë të kërkesës së tyre për integritet politik duke hyrë në një pakt me tjetrin (me kostot e mundshme elektorale për të dyja). Rreziqet e tilla nuk ia vlenin duke nëse shanset reale të hyrjes në qeveri ishin të pakta, ndërsa negociatat komplekse dhe të vështira në fund do të dilnin si një veprim i diskutueshëm - ndërsa paqartësitë mbi procedurat sigurisht e bënë këtë të dukej kështu. Në fund, paqartësitë u lehtësuan pjesërisht nga refuzimi i deputetëve të PAN-it që të nominonin një kandidaturë gjatë mbledhjeve të Kuvendit.

Çështja e kompleksitetit është pa dyshim e rëndësishme në kontekstin e Kosovës si në çdo demokraci tjetër parlamentare. Numri në rritje i partive me asnjë prej tyre në gjendje që të fitojë një shumicë të pastër (absolute), do të thotë se negociatat mbi formimin e qeverisë do të jenë gjithnjë një çështje e ndërlikuar. Një shqetësim në rritje në lidhje me këtë në Kosovë, është se ky proces është kuptuar nga akterët politikë si përgjithësisht një ndarje e plaçkës së pushtetit (përmes caktimit të kontrollit të ministrive dhe posteve të tjera politike për partitë e caktuara), shumë më tepër se sa si negociata mbi programe dhe politika specifike që do të zbatoheshin nga koalicioni qeverisës. Një praktikë e tillë u institucionalizua shumë herët - dikush mund të thotë që nga zgjedhjet e vitit 2004, kur LDK-ja lëshoi pe për kryeministrinë ndaj një partie shumë më të vogël, AAK-së, dhe sërish në vitin 2007, kur marrëveshja PDK-LDK e ndante kontrollin ndërmjet partive sa i përket kryesimit të

Kuvendit, kryeministrisë, dhe presidencës. Përfshirja e presidencës në bisedime të tilla - nominalisht një post apolitik - është shumë për të ardhur keq dhe ka çuar drejt zgjedhjes së liderëve të partive në atë post - Sejdiu i LDK-së, Pacolli i AKR-së (në përpjekjen e tij jetëshkurtër), e deri te Thaçi i PDK-së. Megjithëse, në bazë të Kushtetutës së Kosovës, posti i presidenti është kryesisht një post ceremonial, fakti që presidenti nuk ka kredibilitet për të ndërhyrë gjatë krizave politike dhe shihet se bartë bagazhin dhe animin ndaj partisë politike dhe kjo i dobëson seriozisht kontrollet dhe balancat institucionale.




Figura 6. Gjithsej numri total i të emëruarve politikë të nivelit të lartë në qeveri .²¹

Për më tepër, kompleksiteti i pazareve politike - me

21 Informatat janë të bazuara në përgjigjen e marrë përmes kërkesës zyrtare nga D4D drejtuar Zyrës së Kryeministrit lidhur me këto të dhëna. Të emëruarit politikë përfshijnë ministra, zëvendëskryeministra, dhe zëvendësministra. Në këtë përlogaritje hyn edhe kryeministri. Aty ku një person ka pasur edhe postin e zv/kryeministrit edhe atë të ministrit, është llogaritur vetëm posti më i lartë. Për qeverinë Çeku dhe Thaçi I të dhënat figurojnë nga momenti i votimit të qeverisë. Për qeverinë Thaçi II në përgjigjen në kërkesë nuk figuron numri i zv.ministrave të emëruar. Përlogaritja për qeverinë Haradinaj është e muajit mars 2018.

kontrollin e posteve, objekti kryesor i bisedimeve të tilla - ka çuar gjithashtu në një rritje të shpejtë të numrit të partive në qeveri, numri i zëvendëskryeministrave, numri i ministrive në kabinet, si dhe numrin e zëvendësministrave. Me qeverinë aktuale me njëzet e një ministri, vendi i vogël me dy milionë banorë krenohet me një kabinet më të madh se ai i Gjermanisë. Duke përfshirë numrin e përgjithshëm të të emëruarve politikë (pa këshilltarët politikë, që paraqesin një shtresë shtesë të emërimeve politike) që nga viti 2007 tregon se Kosova po përjeton një rritje dramatike në të gjitha këto pozita (figura 6). Ndonëse ky grup i zgjeruar i personave të emëruar në poste politike në qeveri është pjesërisht rezultat i sistemit të kontrollit të partisë që bazohet në patronazh që është zhvilluar në Kosovën e pasluftës (me çdo parti ose fraksion partiak që duhet të kënaq kërkesat e klientelës së vet politike me punë në sektorin publik, kontrata, pensione, etj.), ai po ashtu paraqet kërcënim për efikasitetin e qeverisjes, kontrollin mbi shpenzimet, koherencën dhe drejtimin e unifikuar të politikave.²² Për shembull, pas marrëveshjes të negociuar me nguti të koalicionit me PDK-në në vitin 2014, qeveria Mustafa e kaloi vitin pasues duke urdhëruar këshilltarët dhe ministritë që të hartonin dokumente strategjike për të përcaktuar qëllimet e qeverisë dhe prioritetet e politikave. Në vitin 2015, për herë të parë në vitin e vet të plotë në pushtet, qeveria Mustafa planifikoi të prodhonte 48 dokumente të tilla ku shtjelloheshin politikat dhe qëllimet që *ende* duhej të zbatoheshin.²³ Duke e shikuar nga jashtë, dikush do të fitonte përshtypjen se qeveria e Kosovës më

22 Për një studim të gjithanshëm të patronazhit politik shih të dhënat e hartuara nga OJQ e pavarur kundër-korrupsion Çohu (<http://opendata.cohu.org/sq/patronazhi-politik>).

23 Shih Qeveria e Kosovës, “Plani i dokumenteve strategjike për vitin 2015,” (QeK: Prishtinë, 2015). Gjetet në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Plani_Vjetor_Dokumenteve__Strategjike_2015_gusht.pdf (për herë të fundit e qasur më 15 nëntor 2017).

shumë ishte institut hulumtues dhe planifikues se sa autoritet ekzekutiv ku partitë janë të zgjedhura për të zbatuar programe dhe politika të cilat ata i kanë hartuar dhe kanë bërë fushatë për to para se të hyjnë në qeveri²⁴.

24 Të mbështeturit në kapacitetet e qeverisë për hulumtim dhe planifikim strategjik për të hartuar politika pjesërisht është për shkak të dobësisë së partive të Kosovës në kapacitetet e tyre të hulumtimit dhe të zhvillimit të politikave. Për shembull, asnjë parti e Kosovës nuk ka asnjë grup ekspertësh të partisë dhe cilado ide politike që ekziston është si rezultat i iniciativës individuale ose - më së shpeshti - një përgjigje ndaj kërkesës ndërkombëtare, me politika që shpesh janë produkt i asistencës teknike ndërkombëtare që ofrohet për t'i përmbushur këto kërkesa. Kjo bën që qeveria nga partitë e Kosovës të trajtohet kryesisht si një burim patronazhi dhe kontrolli dhe shpërndarje e pozicioneve të kabinetit si një lojë e karrigeve muzikore politike.

Konkluzionet dhe rekomandimet

As kohëzgjatja me sa duket jetëshkurtër e qeverive, e as rritja e paqëndrueshmërisë politike nuk paraqesin kërcënime të rënda ndaj demokratizimit të Kosovës. Siç ka treguar diskutimi, qeveritë në Kosovë zakonisht zgjasin më shumë se pjesa më e madhe e qeverive në Evropë. Qeveritë jetë-shkurtra janë normë në sistemet parlamentare. Në të njëjtën kohë, paqëndrueshmëria politike në Kosovë nuk është e re. Paqëndrueshmëria ka qenë e pranishme në vitin 2007, kur skena partiake në Kosovë u ribë me kolapsin e bazës së mbështetjes së LDK-së pas vdekjes së Rugovës. Paqëndrueshmëria u kthye në vitin 2017, me rritjen e LV-së dhe performancën gjithnjë më të përkeqësuar elektorale të PDK-së. Ndonëse zgjedhjet e vitit 2007 u zhvilluan në rrethana të ndryshme (vdekja e liderit afatgjatë të partisë së Rugovës dhe shpallja e mëpastajme e pavarësisë së Kosovës), treguan se votuesit e Kosovës ishin të gatshëm që t'i ndërronin aleancat. I njëjti model u shfaq në vitin 2017, kur mbështetja popullore që shkonte në drejtim të LDK-së dhe PDK-së u devijua drejt LV-së. Edhe pse ky studim nuk fokusohet në elektoratet si të tilla, mund të merren në konsideratë efektet mbi trendet zgjedhore, ardhja e epokës së grupeve të reja demografike me pak përvojë të drejtpërdrejtë në politikën e viteve 1990 ose të fillimit të viteve 2000. Këta votues të rinj mund të tërhiqen nga energjia dhe entuziazmi që përfaqësohet nga LV-ja, gjë që po ashtu kontribuon në zgjerimin e bazës së mbështetjes. Në çdo rast, kërcënimet në rritje ndaj kontrollit politik nga ata që janë në pushtet, për aq sa ato nuk përballen me përpjekjet nga qeveritë për të pakësuar aktivitetin opozitar, krijojnë kushte për transferimin e pushtetit dhe të konkurrencës politike që kontribuojnë drejtpërdrejt në konsolidimin e demokracisë parlamentare në Kosovë.

Një model i ndryshëm del kur i shikon proceset e formimit

të qeverisë dhe modelet e përsëritura të krizës në vitin 2014 dhe në vitin 2017. Siç u vu në dukje nga raporti, këto kriza janë politike për nga origjina dhe artificiale në krijimin e tyre, deri në atë masë sa që ato janë rezultat i keqpërdorimit të rregullave kushtetuese, se sa shkatërrim i normave parlamentare të demokracisë. Ato filluan me dhe përfshinë përforcimin e mekanizmave ligjorë që u lejonin partive dominuese, por që nuk e kanë mbështetjen e shumicës, që ta paralizojë jetën politike si një mjet për përmirësimin e pozitës së tyre në bisedime në procesin e formimit të qeverisë. Siç u vu në dukje nga diskutimi, në fund të fundit ky model i përsëritur është rezultat i një koncepti kushtetues me të meta. Në veçanti, neni 67(2) i Kushtetutës së Kosovës dhe interpretimi i tij nga ana e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në vitin 2014 i ka dhënë partisë apo koalicionit dominues një veto të përhershme mbi formimin e çdo qeverie që nuk e përfshin atë/ata si anëtar. Gjersa në vitin 2014 dhe në vitin 2017 gjendja kishte të bënte me pamundësinë e PDK-së (dhe, në vitin 2017, të koalicionit të madh PAN) që të gjente aleatë qeverisës, në të ardhmen rregullat dhe praktikat ekzistuese mund të prodhojnë një situatë të ngjashme cilido që të jetë identiteti i partisë dominuese (ose koalicionit). Kosova është një nga vendet e pakta evropiane ku rregullat që përcaktojnë zgjedhjen e udhëheqjes parlamentare përcaktohen në kushtetutë, ndërsa në shumicën e vendeve ato përcaktohen me rregullore të brendshme parlamentare. Një zgjidhje e qartë do të ishte që partitë të punojnë bashkërisht për ta ndryshuar nenin 67(2) ose duke e rishkruar këtë rregull në mënyrë që do t'i lejonte çdo parti që të nominojë dikë për kryetar të Kuvendit dhe çdo deputet të bëhej i zgjedhur për aq sa kohë sa ata i kanë votat e të paktën 50 % + 1 deputetëve. Nga ana tjetër, amendamenti mund të përfshinte rishkrimin e nenit 67 në tërësinë e tij duke caktuar rregullimin e zgjedhjes së udhëheqjes së Kuvendit në Rregulloren e Punës së Kuvendit. Për shembull, rregullat

për heqjen dhe zëvendësimin e kryetarit të Kuvendit aktualisht janë të përcaktuara në Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe jo në Kushtetutë.

Në të njëjtën kohë, është e qartë nga objekti i tyre dhe rezultati – bisedimet/pazaret mbi Presidencën, si pjesë përbërëse e negociatave për formimin e qeverive, si dhe rritja e numrit të posteve politike në ekzekutiv që nga viti 2007 për të akomoduar një numër gjithnjë e më të madh të të emëruarve politikë, mungesa e programeve të qarta qeveritare që përcaktojnë se çfarë do të bëjnë në qeveri partnerët e koalicionit - se negociatat mbi formimin e qeverive kanë pasur më pak të bëjnë me qëllimet programore sesa me ndarjen e plaçkës së pushtetit. Ndonëse struktura e partive të Kosovës e organizuar rreth marrëdhënieve të përhapura patron-klient ka shumë të bëjë me këtë, aq ka të bëjë mungesa e kapaciteteve të politikë-bërjes që ka ngecur brenda partive politike. Të gjitha partitë mbështeten në kapacitetet e qeverisë që të prodhojnë qëllimet strategjike dhe platformat e veçanta të politikave për tu implementuar gjersa janë në pushtet. Kjo e ka kthyer qeverisjen aktuale në një lojë të improvizimit që është në kontrast të fortë me vendosmërinë dhe mendësinë e njëjtë që i shtyn partitë dhe liderët në ambiciet e tyre për kontroll mbi postet e larta politike.

Megjithëse ka shkaqe strukturore prapa kësaj gjendjeje, problemi mund të zbutet duke u përqendruar në përpjekjet për trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve brenda partive të mëdha. Partitë duhet të inkurajohen që t'i formojnë resorët për hulumtime të politikave, si dhe të mbështetjes ndërkombëtare, si nga fondacionet evropiane dhe amerikane të partive, si dhe nga grupet trans-nacionale të partive në nivel të BE-së si Partitë Popullore Evropiane dhe Aleanca Progresive e Socialistëve dhe e Demokratëve. Ndonëse disa investime në nivel të ndërtimit të kapaciteteve të partive janë bërë që prej viteve 2000, këto kanë qenë

dukshëm të pamjaftueshme për të transformuar natyrën themelore të organizimit politik në Kosovë, nuk kanë qenë të mjaftueshme për të konsoliduar qëndrimet mbi bazën ideologjike dhe programatike të të gjithë spektrit politik të Kosovës, si dhe për të krijuar mekanizma brenda partive që lejojnë që idetë dhe qëllimet të transformohen në propozime të politikave konkrete. Specializimi i tillë i aktivitetit partiak jo vetëm që do të kontribuonte në profesionalizimin e mëtejshëm të politikës dhe marginalizimin e praktikave klienteliste dhe të taktikave të të “fortit”, por gjithashtu do të zgjeronte mjetet që u mundësojnë partive të përfshihen në dialog më të gjerë që bazohet në politika me anëtarët e shoqërisë civile si dhe do ta zhvendoste polarizimin dhe konkurrencën larg nga mbitheksimi i udhëheqësve individualë në drejtim të programeve dhe qëllimeve që nxiten nga organizata.

Për ta përmbledhur, më poshtë janë dhënë rekomandimet kryesore të raportit:

- Partitë e Kosovës duhet ta ndryshojë nenin 67 të Kushtetutës së Kosovës, e cila lejon që një parti që nuk e ka shumicën t’u kontrollojë dhe potencialisht ta bllokojë procesin e konstituimit të Kuvendit pas zgjedhjeve. Megjithatë ndryshimi i nenit, mund të duket kundër interesave afatshkurtër të partisë në pushtet që dëshiron të qëndrojë në pushtet, apo të një partie që ka shpresë të dalin të parat në zgjedhjet e ardhshme, procedura e mangët shkel normat themelore dhe praktikat demokratike dhe i pengon proceset e formimit të qeverisë, duke gjeneruar kështu kriza politike të panevojshme, të kota, dhe në masë të madhe artificiale, si ato që i kemi parë në vitin 2014 dhe në vitin 2017. Partitë ose mund ta rishkruajnë nenin 67 në mënyrë që ia lejon çdo partie mundësinë që të nominojë kandidatin për kryetar të Kuvendit për aq sa kandidati i nominuar e fiton shumicën e votave nga deputetët, ose mund ta bëjë

këtë duke e shfuqizuar atë nen dhe duke i vendosur rregullat për zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit në rregulloren e punës së Kuvendit duke respektuar parimet e ngjashme të nominimit dhe të zgjedhjes. Zgjedhja t'i lihet një komisioni shumë partiak që do të rishkruante ato dispozita mbi bazë konsensuale.

- Partitë në Kosovë duhet të jenë më të vetëdijshme për nevojën e respektimit të normave elementare demokratike gjatë proceseve të ndjeshme të transferimit të pushtetit pas zgjedhjeve. Transferet paqësore të pushtetit janë procese normale dhe të përhapura në regjimet demokratike. Nga njëra anë, pjesërisht duhet fajësuar përvoja e kufizuar demokratike e Kosovës sa u përket paqartësive të mëdha që krijohen veçanërisht në rastet kur zgjedhjet e përmbysin raportin që ekzistonte më parë në marrëdhëniet mes forcave politike. Nga ana tjetër, partitë në Kosovë kanë qenë shpesh të gatshme të përfitojnë nga zbrastësia ligjore dhe normative në avantazhin e tyre. Kjo praktikë duhet të marrë fund. Në veçanti, Presidenti i Kosovës, duhet të marrë përsipër një rol më të rëndësishëm në mbikëqyrjen e transferimit paqësor të pushtetit, pjesërisht duke i lehtësuar negociatat mbi formimin e koalicioneve, mirëpo duke mos e favorizuar ndonjë parti të veçantë. Për ta forcuar rolin e pavarur institucional të Presidentit, palët duhet që në të ardhmen të përpiqen të shmangin zgjedhjen e ish-udhëheqësve të partisë, si krerë të shtetit, që përfshin shmangien e presidencës si pjesë e pazareve/bisedimeve për koalicion.
- Një pjesë e problemit në pazaret/bisedimet mbi koalicionet pas zgjedhjeve është tendenca e fokusimit në ndarjen e plaçkës politike, përfshirë këtu postet politike të nivelit të lartë, zgjerimin artificial të tyre në mënyrë që të kënaqen fraksionet e ndryshme dhe elektoratet klienteliste. Megjithëse për këtë praktikë ekzistojnë

shkaqe të shumta, një pjesë e saj mund të lehtësohet duke e përqendruar vëmendjen në rritjen e kapaciteteve në politikë-bërje në kuadër të partive politike. Këtu do të përfshiheshin të dyja palët dhe aktorët e jashtëm (si konfederatat partiake ndërkombëtare dhe evropiane, institutet me bazë partiake, agjencitë mbështetëse të zhvillimit demokratik, dhe shoqëria civile vendore), krijimi i politikë-bërjes së brendshme përmes krijimit të resorëve për hulumtim dhe zhvillim të politikave. Përveç bërjes së bisedimeve mbi koalicionet që fokusohen kryesisht në marrëveshjen mbi qëllimet e politikave të rëndësishme sesa në ndarjen e posteve ministrore, kjo po ashtu do t'a përmirësojë efikasitetin e qeverisjes duke e reduktuar kohën e shpenzuar nga akterët politik në vendosjen e qëllimeve strategjike dhe të zhvillimit të politikave sipas parimit “duke parë, duke bërë” gjersa janë në qeveri. Akterët politik duhet ta shfrytëzojnë kohën në opozitë më shumë që t'i drejtojnë organizatat e tyre politike kah ndërtimi i programeve dhe politikave strategjike afatgjata, se sa të mendojnë se këto aspekte shumë të rëndësishme të politikës mund të lihen në dorë të fatit e improvizimit dhe të konsiderohen të rëndësishëm vetëm pasi partia të ketë hyrë në qeveri.

Bibliografia

Dodd, Lawrence. 1976. *Coalitions in Parliamentary Government*. Princeton, NJ: Princeton University Press.

Ecker, Alejandro, and Thomas M. Meyer. 2015. "The Duration of Government Formation Processes in Europe." *Research & Politics* 2 (4):1-9.

Gerring, John. 2007. *Case Study Research: Principles and Practices*. New York: Cambridge University Press.

Goertz, Gary, and James Mahoney. 2012. *A Tale of Two Cultures: Qualitative and Quantitative Research in the Social Sciences*. Princeton: Princeton University Press.

Keudler-Kaiser, Dorothea. 2016. "Party system factors and the formation of minority governments in Central and Eastern Europe: A Qualitative Comparative Analysis." *Zeitschrift für Vergleichende Politikwissenschaft* 10 (3-4):341-369.

Kitschelt, Herbert, Zdenka Mansfeldová, Radoslaw Markowski, and Gábor Tóka. 1999. *Post-Communist Party Systems: Competition, Representation, and Inter-Party Cooperation*. New York: Cambridge University Press.

Lijphart, Arend. 1999. *Patterns of Democracy: Government Forms and Performance in Thirty-Six Countries*. New Haven, CT: Yale University Press.

Linz, Juan J. 1994. "Presidential or Parliamentary Democracy: Does It Make a Difference?" In *Failure of Presidential Democracy*, edited by Juan J. Linz and Arturo Valenzuela. Baltimore: Johns Hopkins University Press.

Mahoney, James. 2008. "Toward a Unified Theory of Causality." *Comparative Political Studies* 40 (2):412-436.

Pedersen, Mogens N. 1979. "The Dynamics of European Party Systems: Changing Patterns of Electoral Volatility." *European Journal of Political Research* 7 (1):1-26.

Pula, Besnik. 2003. "The UN in Kosovo: Administering Democratization?" In *Understanding the War in Kosovo*, edited

by Florian Bieber and Zidas Daskalovski. London: Frank Cass.

Skendaj, Elton. 2014. *Creating Kosovo: International Oversight and the Making of Ethical Institutions*. Ithaca, NY: Cornell University Press.

Somer-Topcu, Zeynep, and Laron K. Williams. 2008. "Survival of the Fittest? Cabinet Duration in Postcommunist Europe." *Comparative Politics* 40 (3):313-329.

Lista e publikimeve

Zgjedhjet dhe partitë politike:

- #1 Instituti D4D. Shtator 2011 Zbërthimi i tredeve zgjedhore 2000-2010.
- #2 Instituti D4D. Mars 2012. Reformë sa për adet: Si të rikthejmë besimin në zgjedhje?
- #3 Malazogu, Leon, Visar Sutaj dhe Drilon Gashi. Nëntor 2012. Auditim i listës së votuesve të Kaçanikut: Mostër për Kosovën
- #4 Malazogu, Leon dhe Selatin Kllokoqi. Shkurt 2013. Mësimet e nxjerra për zgjedhjet e ardhshme – Analizë e zgjedhjeve për kryetar komune në Ferizaj dhe Kaçanik?
- #5 Malazogu, Leon dhe Selatin Kllokoqi. Shtator 2013. Interpretimi i besimit – Përceptimi i përfaqësimit dhe pjesëmarrjes.
- #6 Malazogu, Leon dhe Selatin Kllokoqi. Shtator 2013. Deforma zgjedhore – Dy vite pas, reforma në pikën zero
- #7 Leon Malazogu dhe Brenna Gautam; Me kontribut nga Rezarta Delibashzade dhe Ngadhnjim Halilaj. 26 nëntor 2014. Busolla ideologjike e Kosovës – Hartë e orientimit të partive politike
- #8 Dardan Berisha me kontributin e Driton Qeriqi, Mjellma Hapçiu-Alijaj dhe Rina Vokshi, korrik 2015. Vendosja e drejtësisë në zgjedhje
- #9 Leon Malazogu me kontributin e Ngadhnjim Halilaj dhe Rezarta Delibashzade, korrik 2015 Trendet zgjedhore 2000-2014-Analizë numerike e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit
- #10 Thomas Atherton, Driton Qeriqi dhe Rina Vokshi, Shkurt 2016 Doracak për barazi gjinore në procesin zgjedhor

Rekomandimet e Forumit Reforma

- #1 Instituti D4D. 29 nëntor 2011. Struktura e KQZ-së
- #2 Instituti D4D. 17 janar 2011. Sistemi zgjedhor
- #4 Instituti D4D. 29 nëntor 2011. Riparimi i listës së votuesve
- #5 Instituti D4D. 12 dhjetor 2011. Rekomandimet për Zgjedhjen e Presidentit të Kosovës
- #6 D4D, KIPRED, INPO, KMDLNJ, INDEP, DT, KHK, QPA, dhe NOMP. Reformë të mirëfilltë zgjedhore
- #7 Instituti D4D. 20 dhjetor 2011. Prezantimi i sistemit zgjedhor

Marrëdhëniet ndëretnike

- #1 Malazogu, Leon dhe Vladimir Todorić. Nëntor 2011. Dialogu Beograd – Prishtinë: Nevojitet transformim i interesit vetanak. PER-K/D4D Institute and NPC-Belgrade
- #2&3 Malazogu, Leon, Viktor Popović dhe Shpend Emini. Mars 2012. Perspektiva e një të riu serb në Kosovë/Jeta urbane në vendbanime me shumicë serbe në Kosovë. PER-K/D4D.
- #4 Malazogu, Leon dhe Florian Bieber. Raportet në mes të Beogradit dhe Prishtinës në të ardhmen. PER-K/Instituti D4D
- #5 Malazogu, Leon dhe Alex Grigorev. Shtator 2012. Nga paqartësia kreative në proces konstruktiv – Si ti qasemi veriut të Kosovës? PER-K/Instituti D4D
- #6 Ejđus, Filip, Leon Malazogu dhe Milan Nic. Tetor 2013. Zgjedhjet komunale në veri të Kosovës: Drejt një ekuilibri të ri? Publikuar bashku CEPI, BCSP dhe D4D. (Vetëm në gjuhën angleze)

- #7 Mjellma Hapçiu-Alijaj dhe Ajete Kërçeli. Me kontribut nga: Shpend Emini, Rezarta Delibashzade dhe Ferid Murseli. Tetor 2016. Gratë e fuqizuara: çelës për transformimin e komuniteteve
- #8 Instituti D4D. Dhjetor 2016. Peer-2-Peer: Ndarja e përvojave

Interesi Publik

- #1 Sejdiu, Dardan dhe Kastriot Jahaj. Janar 2013. ‘Taksa’ e fshehur: pse kosovarët paguajnë më shumë?
- #2 Gashi, Dylon and Shoghi Emerson. Maj 2013. Klasë në vete: Patronazhi dhe ndikimi i tij në mobilitetin shoqëror në Kosovë
- #3 Sutaj, Visar and Leon Malazogu. Janar 2013. Le të ngrihet shoqëria civile e vërtetë: Roli i shoqatave me anëtarësi në formësimin e vendimmarrjes në shërbim të interesit publik
- #4 Miftari, Naser. Shtator 2013. Sfida e konsolidimit – Fuqizimi i pavarësisë së institucioneve të medias në Kosovë
- #5 Ardiana Gashi dhe Artane Rizvanolli; Me kontribut nga Natalya Wallin, Rezarta Delibashzade dhe Ngadhnjim Halilaj. 25 shkurt 2015. Sa kushton patriarkati?
- #6 Rezarta Delibashzade, Laura Flemming, Ramadan Klisurica, Agon Maliqi dhe Rina Abazi. 11 Nëntor 2015 Rëndësia e grupeve të interesit: Praktikë, rastet studimore dhe mësimet e nxjerra
- #7 Dukagjin Pupovci dhe Gersi Gashi. Nëntor, 2015 Reformimi i Universiteti të Prishtinës – mision i mundur?
- #8 Leon Malzogu dhe Bernard Nikaj; Me kontribut nga Gulliver Brady. Nëntor, 2016. Nxitje për llogaridhënie dhe performancë më të mirë në arsimin e lartë
-

- #9 Jehona Serhati, me kontribut redaktues nga Abby Riley. Janar, 2017. Stimujt për reformë: Rritja e mundësive për nxënësit/et dhe të diplomuarit/at e AAP-së në tregun e punës
- #10 Isuf Zejna. Korrik 2017. Zhvillimi i turizmit përmes politikave dhe legjislacionit efikas.
- #11 Visar Sutaj. Tetor 2017. Sa të pavarura janë autoritetet rregullatore në Kosovë?
- #12 Linda Abazi Morina dhe Rezarta Delibashzade. Me kontribut nga Ajete Kërçeli dhe Valëza Zogiani. Nëntor 2017. Joaktiviteti i grave në tregun e punës.
- #13 Ajete Kërçeli. Me kontribut nga Ardiana Gashi. Dhjetor 2017. Ndryshimi i paradigmës – Barazi përmes lejes prindërore.
- #14 Vjollca Krasniqi. Mars 2018. Gjendja e vullnetarizmit në Kosovë: Sfidat dhe perspektivat.
- #15 Xhavit Rexhaj. Me kontribut nga Rasim Alija. Prill 2018. Funksionimi i Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës: Analizë e punës dhe vendimeve.

Memorandume Reaguese

- #1 Instituti D4D. Nëntor 2012. Memorandumi reagues Nr. 1 – Reagimi i tepruar i policisë
- #2 Instituti D4D. Dhjetor 2012. Memorandumi reagues Nr. 2 – Modeli i dy Gjermanive
- #3 Instituti D4D. 12 Korrik 2013. Memorandumi reagues Nr. 3 – Kriteretë të qarta për komuna të reja
- #4 Instituti D4D & Qëndrim Gashi. Janar 2013. Memorandum reagues nr. 4 – Universiteti i Prishtinës në rreth vicioz
- #5 Instituti D4D dhe Kushtrim Palushi. Janar 2013. Memorandum reagues nr. 5 – Reforma zgjedhore

- #6 Instituti D4D. Nëntor 2016. Memorandum reagues nr.6 – Reforma zgjedhore

Indikatorët & skenaret

- #1 Instituti D4D. Nëntor 2010. Para dhe Pas-Performanca e bazuar në indikatorë: Vlerësimi vjetor 2010
- #2 Instituti D4D. Qershor 2011. Shteti në Pasqyrë: Indikatorët e Bazuar në Performancë
- #3 Malazogu, Leon. Nëntor 2013. As për emër nuk janë pajtuar: Shtyrja e problemit nuk do të afrojë palët në lidhje me asociacionin/bashkësinë. (Vetëm në gjuhën angleze)
- #4 Malazogu, Leon. Janar 2014. Parashikime dhe skenare: Kosova dhe Bota në 2014
- #5 Agon Nixha. Nëntor 2017. “Analizë e shkurtër e politikave. Investimet e huaja direkte dhe eksportet: Kosova dhe Ballkani Perëndimor.”

Publikime të tjera

- #1 Seritë e editorialeve dhe rekomandimeve gjithashtu mund të gjenden në ueb-faqen tone.

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

321.7(496.51)

Demokracia e Kosovës në rrezik ? : paqëndrueshmëria e sistemit partiak, kohëzgjatja e qeverisë dhe kriza institucionale në Kosovë / punimi i përgatitur nga Besnik Pula. - Prishtinë : Demokraci për zhvillim, 2018. – 64 f. ; 21 cm. – (Seria : Zgjedhjet dhe partitë politike ; 11)

1.Pula, Besnik

ISBN 978-9951-608-71-8

Demokraci për Zhvillim (D4D) është një organizatë hulumtuese e themeluar në vitin 2010 me vizionin se demokracia është parakusht për zhvillim. Themeluesit e D4D-së besojnë se demokracia është mjet dhe qëllim për zhvillim dhe ata i kanë vënë detyrë vetes misionin që të hulumtojnë dhe të përfshijnë një komunitet më të gjerë akterësh drejt këtij qëllimi.

Misioni i D4D -së është të ndikojë në zhvillimin e politikave publike për të përshpejtuar zhvillimin socio-ekonomik të Kosovës, për të përmirësuar qeverisjen dhe për të përforcuar kulturën demokratike në vend.

Për më shumë informata rreth aktiviteteve të D4D-së vizitoni faqen tonë elektronike: www.d4d-ks.org.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK

DANIDA INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION

Ky grant është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

ISBN 978-9951-608-71-8



9 789951 608718